



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte” i
Institucionit të Arsimit të Lartë
Universiteti “BARLETI”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Edi Puka

2. Dr. Vjollca Medja

Qershor / 2022

Për Programin e studimit MP në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Universiteti Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 487, datë 06.10.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.142, datë 10.04.2013
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 06 datë 02.02.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	- Për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 10 PAE dhe 4 PAK. - Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar 10 PAE dhe 2 PAK. - Për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar 10 PAE dhe 4 PAK.
18	Numri i studentëve:	Për vitin akademik: (2018-2020), 135 studentë; (2019-2021), 105 studentë; (2020-2021), 94 studentë; (2021-2022), 127 studentë.
19	Komente / të tjera:	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al




Përmbledhje e vlerësimit të jashtëm të programit

Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte” i ofruar nga “Universiteti Barleti”, si program studimi i ciklit të dytë. Licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Nr. 487, datë 06.10.2012. Ky program studimi u akreditua për herë të parë nga Bordi i Akreditimit me vendim Nr. 06 datë 02.02.2018. *Programi është akredituar për studentët e regjistruar dhe që aktualisht ndjekin këtë program studimi, përfshirë ata të pranuar në vitin akademik 2017-2018 deri ne diplomimin e tyre.*

Referuar konceptit universal që mbart Edukimi dhe Arsimimi, si dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës të identifikuar nga ekspertët, që zotërojnë dije në këto fusha, ky program u hap për herë të parë në vitin 2012. Ky program studimi, i referohet objektivave relativisht të qarta, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që pritet të fitojnë studentët në përfundim. Programi, është i organizuar në module dhe disiplinat lëndore respektive, si dhe i përkthyer në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi shtrihet në dy vite akademike dhe vlerësohet në 120 ECTS. Programi është organizuar duke iu referuar Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktve nënligjore në fuqi.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Pasi, Universiteti Barleti, ka aplikuar për nisjen e procedurës së riakreditimit të programit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit”, ka përzgjedhur dhe kontaktuar dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UniBa, për të kryer vizitën në institucion dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Edi Puka dhe Dr. Vjollca Medja. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ-ja u shoqërua nga Koordinatorin Teknik të ASCAL, për këtë program studimi, Msc. Arjana Alija.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u ngrit me kërkesë të IAL dhe vendim të ASCAL.

Ky proces vlerësimi, përmbushur nga ekspertët në praninë e specialistit të ASCAL, mori në analizë shkallën në të cilën janë përmbushur rekomandimet e lëna në vitin 2018, si dhe shkallën e reflektimit intelektual të stafit që përmbush programin në fjalë, rreth ndryshimeve të mundshme dhe hapësirave ligjore deri në masën 20%. Ekspertët e jashtëm, kanë detyrimin të bëjnë vështrime analitike dhe faktike të situatës, treguesit e matshëm dhe vlerësimin sipas standardeve për kategoritë e përcaktuara në udhëzuesin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm punoi në datat 6 dhe 7 Prill, referuar Agjendës së IAL të konfirmuar nga dy institucionet respektive. U organizuan biseda të qëllimta me stafin, studentët, sekretarinë mësimore si dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore, Njësinë e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë, Zyrën e Koordinimit dhe mbështetjes ndaj Studentëve, u mbledh në mënyrë të qëllimtë informacion dhe u hoqën paralele mes asaj që gojarisht stafet e përfshira artikuluan dhe dokumentacioni që e dokumentonte.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 6, datë 02.02.2018 janë:

- i. Institucioni duhet të marrë masa për rritjen e numrit të stafit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi, me qëllim përmbushjen e të gjitha standardeve sasiore dhe cilësore për mbulimin e ngarkesës mësimore;
- ii. Literatura për këtë program studimi nevojitet të sigurohet për të gjithë studentët e këtij programi dhe të pasurohet me tituj të rinj e që përputhen me natyrën dhe fushën specifike të programit të studimit;
- iii. Institucioni duhet të marrë masa për përmirësimin e nivelit të studentëve në hyrje pasi cilësia aktualisht është e ulët si në hyrje ashtu dhe pas diplomimit të tyre.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. **Institucioni duhet të marrë masa për rritjen e numrit të stafit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi, me qëllim përmbushjen e të gjitha standardeve sasiore dhe cilësore për mbulimin e ngarkesës mësimore;**

Nga vëzhgimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe verifikimi i tij, pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, konstatojmë që IAL, ka marrë masat përkatëse lidhur me numrin e stafit akademik të nevojshëm, për programin e studimit, ndër vite, duke përmbushur standardet sasiore dhe cilësore për mbulimin e ngarkesës mësimore.

2. **Literatura për këtë program studimi nevojitet të sigurohet për të gjithë studentët e këtij programi dhe të pasurohet me tituj të rinj e që përputhen me natyrën dhe fushën specifike të programit të studimit;**

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, si dhe vizitës në institucion, verifikimit të teksteve, pranë bibliotekës së institucionit, konstatojmë që IAL, ka kryer hapa pozitive lidhur me shtimin e numrit të teksteve, në dispozicion të studentëve, për këtë program studimi.

3. **Institucioni duhet të marrë masa për përmirësimin e nivelit të studentëve në hyrje pasi cilësia aktualisht është e ulët si në hyrje ashtu dhe pas diplomimit të tyre.**

Pas verifikimit të dokumentacionit të dërguar nga IAL, si dhe vizitës në institucion, si dhe në takimin me zyrën e Sekretarisë Mësimore, verifikimit të statistikave institucionale, për programin e studimit, konstatojmë se trendi i nivelit të mesatares të studentëve në hyrje është konstant dhe nuk kemi një ndryshim domethënës si vijon: përgjatë viteve 2018-2020 mesatarja në hyrje ka qenë 6.65, në 2019-2021, 6.76, në 2020-2021, 6.3 dhe në vitin 2021-2022, 7.3.

Lidhur me nivelin e studentëve në dalje, domethënë nota mesatare pas përfundimit të studimeve, konstatojmë se trendi i nivelit të mesatares të studentëve ka qenë në rritje, krahasuar me notën mesatare, në hyrje. Bazuar në të dhënat, përkatësisht 2018-2020, 7.2, si dhe 2019-2021, 7.4.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Më datë 23.06.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.20/56 prot, datë 24.06.2022 dërgohet në Institucion Draft-Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 23.06.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr.20/57 Prot, datë 24.06.2022.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1					
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.					
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	E konfirmojmë që programi në fjalë, Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, synon formimin dhe diplomimin e studentëve me dije të thelluara në shkencat e mësimdhënies, procese të cilat dukshëm janë në përmbushje të interesave të larta të nxënësit, çfarë kuptohet që është në rezonancë të thellë me interesat kombëtare. Programi, në thelb, vihet në shërbim të interesave dhe vlerave kombëtare. (Evidencë 7)				
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Rezulton se programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, ruan dhe konsolidon vlerat themelore kombëtare, si dhe vlerat universale humane. Programi i studimit u ofron studentëve mundësi të nxëni të qëndrueshëm, në kushte tërësisht etike, në ruajtje të plotë të individualitetit dhe eksperiencës së çdo studenti. (Evidencë 7 & 3) Konstatojmë gjithashtu, që programi është në rezonancë me politikat kombëtare të përcaktuara në “Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë” të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe në përmbushje të legjislacionit respektiv.				
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Konfirmojmë që: IAL ofron cikle të plotë studimi si: programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimit (Bachelor dhe Master). Programet janë hartuar dukshëm në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, është hartuar në frymën e Bolonjës dhe Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve ECTS. (Evidencë 2 & 7)				
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Konstatojmë që, Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte” i referohet nevojave të tregut të punës specifikisht në tregun e arsimit dhe edukimit në përgjithësi. Nga vizitat në institucion, si dhe në takimet me stafin dhe studentet identifikua nevojën për ngritjen e figurës së “Edukatorit/Mësuesit”, në arsimin parauniversitar. (Evidencë 14.2)				
	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@asca.al

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al




Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Konstatojmë që, programi i studimit në fjalë, është përshtatur sipas Strategjisë për Zhvillim të Institucionit (Evidencë 3), Planit Strategjik të këtij Departamenti (Evidencë 4) dhe “Rregullores Institucionale” (Evidencë 5).			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Konstatojmë që, programi në fjalë është hartuar në përputhje me prioritetet akademike të përcaktuara në Statutin e UniBa, (Evidencë 3), ku theksohet dukshëm që, prioritetet akademike përfshijnë detyrimin që IAL të ketë ndikim në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor në edukim dhe mësimdhënie, duke iu shërbyer vlerave themelore të njeriut përmes prodhimit, zhvillimit dhe përhapjes së njohurive në fushat e edukimit.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Konstatojmë që, emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit që ofrohet, lëndët dhe çështjet që trajtohen gjatë programit. Programi është hartuar në përputhje me nivelin 7 të kualifikimeve të përcaktuara nga Korniza e Kualifikimeve Shqiptare.			
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Konfirmojmë që, programi Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, është hartuar në përputhje me strategjinë e institucionit dhe synon të përmbushë nevojat e identifikuar nga tregu i punës dhe nga stafet akademike brenda IAL. (Evidencë 3 & 6b)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Konstatojmë që, në vija të përgjithëshme programi ka objektiva relativisht të qarta për formimin e vazhdueshëm të studentëve. Gjithashtu, në pikëpamjen formale programi është i organizuar në module të shkruara referuar një formati unik të miratuar nga IAL dhe që lehtëson menaxhimin dhe kontrollin e tyre. Modulet gjenden në bankën elektronike dhe janë të aksesueshme nga çdo i interesuar. (Evidencë 7)
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe	Konstatojmë se: ekziston një studim tregu nga IAL, por ka dy mënyra për të bërë kërkimin kur hapen programe studimi: një kërkim që identifikohet

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

<p>në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>nga tregu dhe nevoja për punësim, dhe një kërkim që bëhet nga bota akademike e cila i ofron tregut diçka që vetë tregu nuk e identifikon dot. Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës si dhe trendit në edukim, i cili kërkon të orientojë studentët në fushën e mësuesisë.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Konstatohet që, programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, prirret të pajisë studentët me njohuri mbi metoda e parime krijuese-shkencore të përgjithshme mbi profesionin e mësuesit në institucionet arsimore. Dukshëm, qëllimi i kësaj kurrikule është t’u ofrojë studentëve njohuri të cilat do të jenë të nevojshme për të ushtruar profesionin e mësuesit të edukimit fizik. (Evidencë 14.2)</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Konstatohet që, programi ofrohet në module të veçanta dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi mbështetet në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane, për nga elementët që përmban si psh. të dhëna të përgjithshme, kreditet, kushtet e pranimit në to, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Konfirmohet që, Profesionin e Mësuesit dhe Diploma e Mësuesisë përfshihet tek profesionet e rregulluara dhe për të fituar të drejtën e ushtrimit të tij duhet të përmbushen tre kritere: Duke iu referuar Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 dhe konkretisht neni 83 pika 2 shprehet se, “Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit.”, studenti duhet të ndjekë një program studimi në ciklin e dytë për të ushtruar profesionin e mësuesit të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë; 1. të ketë kryer me sukses praktikën profesionale; 2. të ketë kaluar me sukses provimin e shtetit. 3. të disponojë licencën e ushtrimit të profesionit.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Konstatohet që, programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, në planin e tij mësimor ka të implementuar edhe modulën e praktikës mësimore, e cila u potencion mundësinë studentëve të prekin nga afër profesionin e mësuesit të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë. (Evidencë 69 & 7)</p>
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit, aktualisht, nuk angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj, pasi UniBa nuk ofron mësimdhënie në gjuhë të huaj, në këtë fushë studimi, pavarësisht se stafi akademik zotëron gjuhë të huaja të certifikuara nga institucione të akredituara.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al





<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, ka pasur të regjistruar për vitet akademike 2018-2020, 135 studentë, për vitet akademike 2019-2021, 105 studentë.</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, 94 studentë dhe për vitin akademik 2021-2022, 127 studentë. (Evidencë Dok. Shtesë 6)</p> <p>Për vitin akademik 2018-2020, janë diplomuar 220 studentë, nga të cilët, janë punësuar 179, 61 janë punësuar në përputhje me diplomën dhe 118, jo në përputhje me diplomën. (Evidencë Dok. Shtesë 9)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.4 Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Konstatjmë që, IAL ka mjaftueshëm staf profesional që të përmbushë nevojat e programit. (Evidencë 24)</p> <p>Një pjesë e mirë e stafit vijnë nga institucione kombëtare ku janë prodhuar kurrikulat kombëtare të sistemit parauniversitar dhe e njohin mirë sistemin parauniversitar.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Konstatojmë se, struktura e fakultetit, ku zhvillohet programi në fjalë, ka mjaftueshëm kapacitet për të përmbushur objektivat e përgjithshme dhe specifike të programit në fjalë. (Evidencë 7)</p> <p>Ky program, është në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi, (LAL dhe aktet nënligjore në zbatim të tij), me aktet e tjera rregullatore të UniBa, si dhe në përputhje me Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, standardet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.</p> <p>Gjithashtu, ky program është hartuar në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar - niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të DEFS. Ky Departament ofron edhe 3 programe të tjera përkatësisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Diplomë profesionale në: “Operator në fitnes, palestër dhe organizim eventesh publike”; 2. Bachelor në “Edukim fizik dhe sporte”. 3. Master Shkencor në: “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”; <p>Të gjitha programet e studimit janë në përputhje me kualifikimet dhe udhëzimet kombëtare e evropiane si dhe fushën e tyre të studimit. (Evidencë 6b).</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>Konstatojmë se, IAL nuk ka ofruar programe në fushën e mësuesisë në edukim fizik, përtej fuqisë së tij profesionale dhe jo domodoshmërisht i duhet të garantohej cilësia nga institucione partnere.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Shkalla e përbushjes së standardit	Niveli i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al



Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Konstatohet që, IAL, lidhur me programin e studimit, ka hartuar memorandume bashkëpunimi dhe marrëveshje brenda vendit. Këto i ben referuar ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi, në mënyrë që të përmbushë misionin e tij. Bashkëpunimi, si parim dhe procedurë, funksionon brenda vetë departamentit, në nivel kombëtar. (Evidencë Dok. Shtesë 1) Njësitë administrative respektive si: Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë, Zyra e Dekanit të Studentëve, Zyra e Alumnit dhe Karrierës, Zyra e Pranimit, Rekrutimi dhe Regjistrimit, ofrojnë bashkëpunime në nivele të ndryshme për arritjen e objektivave të programit. (Evidencë 12)
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Konfirmohet që, Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë aktivitete ekstrakurrikulare të studentëve të programit. Këto marrëveshje janë të vlefshme kryesisht për realizimin e praktikave mësimore të studentëve, referuar programit të studimit që parashikon këtë lëndë. (Evidencë Dok. Shtesë 1) Këto marrëveshje, specifikojnë sistemin e mentorimit të praktikës. (Evidencë Dok. Shtesë 1) Marrëveshjet, hartohen çdo vit akademik, sipas afateve të përcaktuara, për zhvillimin e praktikave profesionale.
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Rezulton se, marrëveshjet të posaçme që institucioni ka nënshkruar, specifikojnë sistemin e mentorimit të praktikës. (Evidencë Dok. Shtesë 1). Marrëveshjet hartohen çdo vit akademik, bazuar në afatet kohore të vlefshmërisë së tyre.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Konstatohet që, praktika mësimore mbikëqyrjet nga pedagogët e IAL, që kanë statusin e mentorit. Institucioni krijon raport zyrtar me institucione arsimore parauniversitare, për zhvillimin e praktikave profesionale. (Evidencë Dok. Shtesë 1) Pedagogu përgjegjës për praktikën profesionale, merr pjesë në orët e hapura që studenti praktikant organizon në institucionin ku zhvillon praktikën mësimore.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, si dhe me Klubin Studentor të Karrierës dhe Orientimit, gjatë vitit akademik 2021-2022, ka organizuar një sërë aktivitete lidhur me orientimin për një karrierë të suksesshme, pas përfundimit të programit. (Evidencë Dok. Shtesë 9.11.12)
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të	IAL dhe Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, ku zhvillohet programi në fjalë, ka bërë që marrëveshjet e bashkëpunimit të vendosura me institucione të ndryshme t'i vërë në funksion të programit të studimit, si rasti i marrëveshjes me Shkollën 9 vjeçare 100 vjetori etj, duke bërë të mundur realizimin me sukses të praktikave profesionale, për këtë program studimi. (Evidencë Dok. Shtesë 1)

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

realizimit të programeve të studimeve.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Konfirmojmë që , Programi i studimit Master Profesional në: “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, organizohet në lëndë dhe module, bazuar në legjislacionin në fuqi. Kohëzgjatja normale e studimeve në këtë program studimi është dy vite akademike, (katër semestra), të cilave u korrespondojnë 120 kredite (ECTS), në total. (Evidencë 14.2)
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	Theksojmë që , plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në: “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, është hartuar në përputhje me dispozitat nënligjore në fuqi, <i>por vërehet një mospërputhje në përqindjet sipas kategorive, specifikisht te grupi B kemi 57% në ngarkesë për kredite, duke mos respektuar masën 30%-40% në kredite, ndërsa në grupin C, kemi ngarkesë 20 kredite, duke mos respektuar masën 20%-30%</i> , bazuar në VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. <i>Rekomandojmë rishikimin e plan-programit në respektim të VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. (Evidencë 14.2)</i>
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Theksojmë që , programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë ata deri në diplomimin e tyre. (Evidencë 4 & 7) Gjithashtu, ky program mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive që pritet të kenë përfituar në kurset teorike.
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose	Studentët që diplomohen në Programin e Studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, përgatiten për të ushtruar profesionin e mësuesit të arsimit të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë, <i>por vërehet një keqkuptim ligjor,</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Email: info@ascal.al

<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p><i>duke evidentuar edhe mundësinë ndjekjes të studimeve në ciklin e tretë të studimeve. (Evidencë 7)</i></p> <p>Fakt ky, që bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ku citojmë: neni 78, “Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Masteri i Shkencave” ose “Master i arteve” dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë”.</p> <p><i>Sa më sipër rekomandojmë, rishikimin e Rregullores së Programit të Studimit, lidhur me objektivat dhe mundësinë e studimeve të mëtejshme të studentëve që diplomohen në këtë program studimi.</i></p>		
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>E theksojmë që, përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”. (Evidencë 6 & 7)</p> <p>Emërtimi i Programit të Studimit është në përputhje me nivelin e Kualifikimit Kombëtar të Programeve të Studimit, niveli 7 në përshtatshmëri me lëndët dhe çështjet që trajtohen gjatë programit.</p>		
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Rezulton se, shpërndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese dhe krediteve është e përcaktuar në planin mësimor, por vërehet një mospërputhje në përqindjet sipas kategorive, specifikisht te grupi B kemi 57% në ngarkesë për kredite, duke mos respektuar masën 30%-40% në kredite, ndërsa në grupin C, kemi ngarkesë 20 kredite, duke mos respektuar masën 20%-30%, bazuar në VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.</p> <p><i>Rekomandojmë rishikimin e plan-programit në respektim të VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.</i></p>		
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Programi i Studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, siç u përmend më lartë, parashikon zhvillimin e lëndës Praktikë Profesionale me 12 ECTS. (Evidencë 14.2).</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Konfirmojmë që, funksionon NJZHKC si zyra përgjegjëse, në bashkëpunim me njësinë bazë, për vlerësimin dhe akreditimin e programeve. (Evidencë 8)</p> <p>Nga takimet në institucion konstatuam të ketë pasur lëvizje të stafit ekzistues dhe emërim të stafit të ri. Gjithsesi, dukshëm u konstatua përgjegjësia e zyrës. Personi në këtë zyrë njëjtte mjaftueshëm detyrimet ligjore dhe procedurat që parashikohen në ligj, për të bërë vlerësimin dhe sugjeruar nevojën për akreditim të programeve.</p> <p>Konstatuam gjithashtu, se kishin ngritur instrumente, përmes të cilëve bëhet vlerësimi i programeve dhe kur identifikohet momenti i nevojshëm për ri-akreditim të programit.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Konstatuam se, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve është përgjegjës për programin e studimit dhe plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore për organizimin akademik dhe strukturor të specifikuar. Ky departament funksionon sipas Rregullores së Departamentit. (Evidencë 6b)</p> <p>Personeli akademik i Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve është i kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë. Ky departament përbëhet nga staf akademik me kohë të plotë të cilët kanë një eksperiencë të gjatë në fushën e arsimit dhe janë të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Konfirmojmë se, Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, si dhe mban përgjegjësinë për të rregulluar raportet mes stafit të brendshëm dhe të jashtëm referuar hapësirës ligjore, konkretisht: udhëzimit Nr. 29, datë 10/09/2018 të MAS, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, Senati Akademik i UniBa, ka marrë vendim, që ngarkesa mësimore vjetore për autoritetet drejtuese dhe personelin akademik të jetë në përputhje me nevojat e njësisë bazë. (Evidencë Dok. Shtesë 3)</p> <p>Personeli akademik në funksion të programit të studimit, përbëhet nga <i>profesorë dhe lektorë</i> me kohë të plotë ose të pjesshme, si dhe personel akademik i ftuar ku përfshihen profesorë dhe lektorë.</p> <p>Nga raporti i vlerësimit të brendshëm, Tabelat nr.6, 6.1, 6.2 dhe 6.3, konstatohet se në këtë departament, për vitin akademik 2018-2019, numri i personelit akademik efektiv ka qënë 5 (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor” - 1 mbajnë titullin akademik “Profesor i Asociuar” - 2 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Përsa i përket personelit akademik me kontratë, janë gjithsej 5 (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 “Profesor i Asociuar” - 4 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Për vitin akademik 2019-2020, numri i personelit akademik efektiv ka rezultuar se është 10 (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor” - 1 mbajnë titullin akademik “Profesor i Asociuar” - 6 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave”

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

	<p>Përsa i përket personelit akademik me kontratë, janë gjithsej 4 (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 “Profesor i Asociuar” - 2 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Për vitin akademik 2020-2021, numri i personelit akademik efektiv ka rezulton se është 10 (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor” - 1 mbajnë titullin akademik “Profesor i Asociuar” - 6 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Përsa i përket personelit akademik me kontratë, janë gjithsej 2 (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 “Profesor i Asociuar” - 1 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Ndërsa për vitin akademik 2021-2022, numri i personelit akademik efektiv ka rezulton se është 10 (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor” - 2 mbajnë titullin akademik “Profesor i Asociuar” - 5 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Përsa i përket personelit akademik me kontratë, janë gjithsej 4 (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 “Profesor i Asociuar” - 2 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave”
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Konfirmojmë se, Departamenti i EFS, zyrtarisht është përgjegjës për programin e studimit dhe plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore për organizimin akademik dhe strukturor të specifikuar. (Evidencë 5 & 6). DEFS përgjegjëse për programin e studimit në shqyrtim përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Ai ka në përbërje 24 anëtarë, 12 me kohë të plotë: 1 Prof.; 2 Dr; 9 MSc; dhe 12 me kohë të pjesshme: 1 Prof.As, 1 Dr, 10 MSc.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Konfirmojmë që, Departamenti i EFS është i kualifikuar mjaftueshëm me grada dhe tituj shkencorë. Ky departament ka angazhuar personel akademik të kualifikuar, si dhe mentor për udhëheqjen e praktikave mësimore të cilat zhvillohen në institucionet e arsimit parauniversitar. (Evidencë 24)</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Konfirmojmë që, Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, bazuar në Urdhrin e Rektorit, (Evidencë 36), cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e përcaktuara në Rregulloren e Departamentit si dhe dokumentacionin e zhvillimit të praktikave. (Evidencë 6b & 36)</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësise përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Koordinatori i programit të studimit ndjek në mënyrë periodike dhe raporton në mënyrë hierarkike çdo nevojë për ndryshim. (Evidencë 6b)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X


Standardi II.3

Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Konfirmojmë se, Drejtuesi i Departamentit të EFS dhe të gjithë strukturat e departamentit kanë informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit. Ato janë në koherencë me të rejat e fundit të legjislacionit në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Konfirmojmë se, Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, ka një plan mësimor të organizuar, deri-diku, në përputhje me VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. Programi është i formatuar në disiplina të grupit A, grupit B, Grupit C, Grupit D dhe E duke respektuar specifikat, por vërehet një mospërputhje në përqindjet sipas kategorive, specifikisht te grupi B kemi 57% në ngarkesë për kredite, duke mos respektuar masën 30%-40% në kredite, ndërsa në grupin C, kemi ngarkesë 20 kredite, duke mos respektuar masën 20%-30%, bazuar në VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. <i>Rekomandojmë rishikimin e plan-programit në respektim të VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.</i>
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Konfirmojmë se, plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte” është i organizuar në lëndë, module dhe praktika, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, të cilat janë të vlerësuara me kredite sipas sistemit kombëtar dhe evropian, dy vite akademike, përkatësisht katër semestra, por vërehet një mospërputhje në përqindjet sipas kategorive, specifikisht te grupi B kemi 57% në ngarkesë për kredite, duke mos respektuar masën 30%-40% në kredite, ndërsa në grupin C, kemi ngarkesë 20 kredite, duke mos respektuar masën 20%-30%, në kredite, bazuar në VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

	<p><i>Rekomandojmë rishikimin e plan-programit në respektim të VKM Nr.41 datë 21.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Konfirmojmë se, Programi është i ndërtuar konform formateve të lejuara nga ligji dhe përfshijnë një informacion të hollësishëm mbi ngarkesën e punës mësimore në auditor apo jashtë tij, frekuentimin e lëndës si dhe metodat e vlerësimit të njohurive, apo penalizimet në mos përmbushje për arsye të ndryshme.</p> <p>Plan-programi i studimit është hartuar bazuar në legjislacionin në fuqi, i ndarë në kredite dhe disiplina karakterizuese përkatëse. Kreditet janë të ndara në leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktikë, si edhe punë e pavarur e studentëve.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte", ka në total 120 ECTS, për 2 vite akademike, 30 ECTS çdo semester.</p> <p>Konstatojmë që, ndarja e kategorive të veprimtarive formuese nuk është në përputhje të plotë me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", të ndryshuar, pasi vërehet një mospërputhje në përqindjet sipas kategorive, specifikisht te grupi B kemi 57% në ngarkesë për kredite, duke mos respektuar masën 30%-40% në kredite, ndërsa në grupin C, kemi ngarkesë 20 kredite, duke mos respektuar masën 20%-30%, në kredite, bazuar në VKM Nr.41 datë 21.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar.</p> <p><i>Rekomandojmë rishikimin e plan-programit në respektim të VKM Nr.41 datë 21.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Konstatojmë se, Zyrat për studentët dhe zhvillim të karrierës u ofrojnë studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve të cilat specifikohen mjaft qartë në "Manual Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim". (Evidencë 65)</p> <p>(Kjo u konstatua edhe gjatë takimit me studentët.)</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>U konstatua se, Programet lëndore të programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte", janë të organizuara në përputhje deri-diku me formatet e miratuara, por një pjesë e mirë e silabuseve të programit të studimit nuk përmbajnë të gjithë komponentët e nevojshëm dhe informacionin mbi organizimin e secilës lëndë, modul apo praktikë. (Evidencë 19)</p> <p><i>Rekomandojmë rishikimin dhe përmirësimin e formateve, bazuar në aktet nënligjore në fuqi.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Konfirmojmë, angazhimin e Departamentit për rishikimin dhe përditësimin e programeve të studimit dhe planit mësimor bazuar në nevojat dhe treguesit akademik. Kjo procedurë ndiqet me rigorozitet duke zbatuar me përpikmëri masën e lejuar mbi ndryshimet përkatëse në planin mësimor si dhe në zbatim të akteve nënligjore në fuqi. (Evidencë 52)</p> <p>Përgjithësisht, njësia bazë ndjek një procedurë mbi përditësimin dhe përmirësimin e silabuseve, ku në fund të vitit akademik titullarët e lëndëve në bashkëpunim me grupin e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

	angazhohen në rishikimin e programeve lëndore, por sërish vërehen problematika në zbatimin e formatit të kërkuar. <i>Rekomandojmë rishikimin dhe përmirësimin e formateve, bazuar në aktet nënligjore në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al



Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Konfirmojmë që, shpërndarja e ngarkesës lëndore përcaktohet në silabusin e secilës lëndë. Duke iu referuar kornizës ligjore kombëtare, një kredit (ECTS) korrespondon me 25 orë pune të një studenti dhe sasia mesatare e punës së përfunduar gjatë një viti të studimeve për një student është 60 (gjashtëdhjetë) ECTS ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë të orarit të punës së studentëve, i cili përfshin orë në auditor dhe orët e punës së pavaruar. (Evidence 14.2)</p> <p>Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare/ushtrime dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite ECTS. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në krediteve (në %) për veprimtaritë formuese nuk është në pajtim të plotë me VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, pasi vërehet një mospërputhje në përqindjet sipas kategorive, specifikisht te grupi B kemi 57% në ngarkesë për kredite, duke mos respektuar masën 30%-40% në kredite, ndërsa në grupin C, kemi ngarkesë 20 kredite, duke mos respektuar masën 20%-30%, në kredite, bazuar në VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.</p> <p><i>Rekomandojmë rishikimin e plan-programit në respektim të VKM Nr. 41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Konstatojmë se, shpërndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese në: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, integruese dhe plotësuese, ndihmon studentët të fitojnë njohuri, të përmirësojnë aftësitë dhe të rrisin mundësitë e punësimit të tyre, siç shprehet edhe në planin strategjik të programit të studimit. (Evidence 4)</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Konstatojmë se, ndarja e lëndëve në semestra dhe kredite ka pësuar ndryshime, mjaftueshëm, sa ky organizim të nxisë te studentët në arritjen e objektivave të programit të studimit, rezultateve të pritura dhe rezultateve të mësimin siç përcaktohet në kurrikulën e programit të studimit. (Evidence 14.2)</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Konstatojmë që, struktura e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, si dhe lëndët dhe përcaktimet e tyre në semestra, kredite, teori apo praktikë janë mjaftueshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të</p>	<p>Konstatojmë që, veprimtaritë formuese përmes trajtimeve teorike, praktike, seminareve apo aktivitete të tjera, lehtësojnë arritjen e objektivave mësimore, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin në fund të programit të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al




studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	studimit, në përputhje me standardet akademike dhe strategjinë e zhvillimit të UniBa. (Evidencë 3)		
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Konstatohet se , në parim, funksionon që në fillim të çdo viti akademik pedagogëve u kërkohet të përditësojnë silabuset. Ata i përditësojnë duke iu referuar literaturës së detyruar apo ndihmëse vendase dhe të huaj të azhurnuar në 5 vitet e fundit me profilin specifik lëndor, por praktikisht evidentohen problematika të theksuara në zbatimin e formateve respektive. (Evidencë 19) <i>Rekomandohet rishikimin dhe përmirësimin e formateve, bazuar në aktet nënligjore në fuqi.</i>		
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Konfirmohet se , programi është në përputhje me profilin e UniBa dhe strategjinë e tij për zhvillim. Një nga objektivat e këtij programi studimi është formimi i studentëve, në dijet, aftësitë dhe kompetencat deri në punësimin e tyre. Kjo është arsyeja pse Departamenti interesohet deri në procesin e licensimit të studentëve. Duke hetuar se cila nga pjesa e programit mund të kishte funksionuar më mirë dhe si mund të përmirësohet. (Evidencë Dok. Shtesë 9)		
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Konfirmohet se , ky program studimi është në përputhje me Nenin 6 të ligjit Nr. 10247, datë 26.05.2017 “Për Kornizën Shqiptare të kualifikimit”, i ndryshuar, por vërehet një mospërputhje në përqindjet sipas kategorive, specifikisht te grupi B kemi 57% në ngarkesë për kredite, duke mos respektuar masën 30%-40% në kredite, ndërsa në grupin C, kemi ngarkesë 20 kredite, duke mos respektuar masën 20%-30%, në kredite, bazuar në VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. <i>Rekomandohet rishikimin e plan-programit në respektim të VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.</i>		
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Konstatohet se , ka një program mentorimi të strukturuar mbi të cilën të udhëhiqen studentët në karrierën e tyre, siç kemi konstatuar më sipër. IAL disponon lista të regullta të çdo studenti deri në procesin e licensimit dhe punësimin. Programi, i mundëson studentëve, vijimin e karrierës së tyre profesionale dhe punësimin, bazuar në legjislacionin në fuqi.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit	Konfirmohet që , programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, ka një staf akademik të kualifikuar me përvojë të gjatë në mësimdhënie. I gjithë stafi akademik me kohë të plotë dhe me kohë


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

<p>të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>të pjesëshme është i kualifikuar me grada e tituj shkencorë që parashikohen në ligj. (Evidencë 24).</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, numri i personelit akademik efektiv ka rezulton se është 10 (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor” - 2 mbajnë titullin akademik “Profesor i Asociuar” - 5 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Përsa i përket personelit akademik me kontratë, janë gjithsej 4 (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 “Profesor i Asociuar” - 2 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave”
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se, stafi akademik i angazhuar në programin e studimit ka përgjithësisht kualifikimet e duhura në nivelin e kërkuar për të menaxhuar modulet e lëndëve me të gjitha specifikat e tyre. Ata mbajnë titujt dhe gradat Profesorë, Profesorë të Asociuar dhe gradën shkencore Doktor i Shkencave. Ngarkesa e tyre mësimore, përgjithësisht shkon në përputhje me fushën e tyre specifike të studimit. (Evidencë Dok. Shtesë 3)</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Rezultoni se, në këtë departament, për vitin akademik 2018-2019, numri i personelit akademik efektiv ka qënë 5 (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor” - 1 mbajnë titullin akademik “Profesor i Asociuar” - 2 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Përsa i përket personelit akademik me kontratë, janë gjithsej 5 (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 “Profesor i Asociuar” - 4 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Për vitin akademik 2019-2020, numri i personelit akademik efektiv ka rezulton se është 10 (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor” - 1 mbajnë titullin akademik “Profesor i Asociuar” - 6 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Përsa i përket personelit akademik me kontratë, janë gjithsej 4 (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 “Profesor i Asociuar” - 2 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Për vitin akademik 2020-2021, numri i personelit akademik efektiv ka rezulton se është 10 (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor” - 1 mbajnë titullin akademik “Profesor i Asociuar” - 6 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave”

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

	<p>Përsa i përket personelit akademik me kontratë, janë gjithsej 2 (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 “Profesor i Asociuar” - 1 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Ndërsa për vitin akademik 2021-2022, numri i personelit akademik efektiv ka rezulton se është 10 (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor” - 2 mbajnë titullin akademik “Profesor i Asociuar” - 5 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Përsa i përket personelit akademik me kontratë, janë gjithsej 4 (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 “Profesor i Asociuar” - 2 janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” <p>Konstatohet se, ka një rritje ndër vite të nivelit të kualifikimit të stafit akademik dhe përgjithësisht niveli i kualifikimit dhe fushat e përgjithshme dhe specifike akademike dhe ato kërkimore të angazhuar në programin e studimit, janë në përputhje me kërkesat, objektivat dhe specifitetet e programit të studimit. (Evidencë 24)</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se, duke iu referuar Rregullores së programit të studimit (Evidencë 7), specifikohet mjaft qartë që studentët të cilët mbrojnë provën finale, mënyrën etj. Departamenti, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, nëpërmjet pedagogut udhëheqës të praktikave profesionale, bën të mundur mbikëqyrjen e studentëve në institucionet ku ata zhvillojnë praktikat profesionale. Udhëheqësi i praktikave profesionale krijon një lidhje bashkëpunimi midis studentit praktikant dhe mentorit në institucionin pritis.</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Konfirmohet se, IAL, garanton zhvillimin cilësor të procesit mësimor, duke përcaktuar personelin përgjegjës, për zhvillimin e praktikave mësimore, si dhe mbarëvajtjen e orëve dhe seminareve praktike specifike, për këtë program studimi, ky fakt, u konstatua gjatë vizitës në institucion, lidhur me verifikimin e ambienteve dhe personelit përgjegjës.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="592 1570 743 1637">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="743 1570 956 1637">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="956 1570 1166 1637">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1166 1570 1380 1637">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="592 1637 743 1684"></td> <td data-bbox="743 1637 956 1684"></td> <td data-bbox="956 1637 1166 1684"></td> <td data-bbox="1166 1637 1380 1684" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.6

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al




Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Konfirmojmë se, Njësia Bazë, Zyra e Karrierës dhe Alumnit dhe Institucioni marrin feedback dhe konsultohen me partnerët strategjikë akademike. Përfaqësues të institucionit marrin pjesë në panairë të përvitëshme të punës dhe biznesit për t'u konsultuar, rakorduar dhe përmirësuar programet e studimit sipas kërkesave të tregut për kualifikimin e profesionistëve dhe të punësuarit e programeve respektive. (Evidencë Dok. Shtesë 4) Gjithashtu për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, NJZHKC, është përgjegjëse për koordinimin dhe vlerësimin semestral të programeve të studimit. Ajo funksionin në bashkëpunimin me departamentet përgjegjëse, pas sugjerimeve përkatëse që departamenti ngre pas studimit të tregut të punës (Evidencë 8, 16 & 17)			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Konfirmojmë që, në procesin e përmirësimit të programeve të studimit përfshihen aktivisht edhe sugjerimet, kërkesat dhe pritshmëritë e studentëve, qoftë përmes raporteve të Njesisë Bazë, qoftë përmes pyetësorëve vlerësues të kryer nga NJZHKC, çdo semester akademik.			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Konstatuam që, disponohet dokumentacion i mirëorganizuar i studentëve aktualë dhe atyre të punësuar dhe se kishte kontakte të qëlimta me studentët, kjo u konstatua jo vetëm nga dokumentacioni por dhe gjatë bashkëbisedës së qëllim të me studentët dhe stafin. Njësia përgjegjëse, Zyra e Karrierës dhe Alumnit dhe Institucioni marrin feedback dhe konsultohen me studentët e diplomuar për të marrë prej tyre sugjerime mbi përmirësimet të mundshme të programit të studimit. (Evidencë Dok. Shtesë 9)			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Programi i studimit Master Profesional në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte", zhvillohet pranueshëm në linjë me kërkesat e tregut dhe në përshtatje me nevojat e institucioneve partnere, qoftë institucione publike, qoftë ente të shërbimit privat si pjesë e planit strategjik të zhvillimit të UniBa. (Evidencë 3)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Konstatuam që, ka udhëzues që qartësojnë studentët dhe të interesuarit rreth qëllimit dhe metodologjisë që përmbush programi në fjalë. Mësimdhënia në këtë program studimi bëhet sipas standardeve të vendosura nga UniBa, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Gjithashtu, UniBa ka hartuar dhe përdor udhëzues apo manuale të ndryshme informuese, ku përfshihet edhe informacioni mbi mësimdhënien në UniBa.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Konfirmojmë që, IAL monitoron dhe vlerëson me përgjegjshmëri në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik si dhe të atij administrativ, i cili është në funksion të programit të studimit. Zyra e zhvillimit të kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë, organizon dhe zhvillon një pyetësor me studentët e të gjitha cikleve, i cili bën të mundur vlerësimin dhe matjen e performancës së stafit akademik dhe atij administrativ. (Evidencë 40 & 41)</p> <p>Rezultatet përpunohen dhe i përcillen për dijeni instancave përkatëse, të cilat nga ana tjetër ndërmarrin veprimet përkatëse korrigjuese për përmirësimin e cilësisë në programin e studimit. Fokus grupet janë një tjetër instrument, që mund të aplikohen periodikisht me qëllim përmirësimin e të gjitha specifikave, por përgjatë tre viteve të fundit, nuk rezulton që të jenë zhvilluar, nisur edhe nga problematika dyvjeçare, si pasojë e Pandemisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Konstatuam se, institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. Për të tërhequr mendimin e studentëve, çdo vit organizohen pyetësorët me studentët sipas një formati të adoptuar nga UniBa për këtë qëllim.</p> <p>Pyetësorët organizohen në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimatin, në mënyrë që të reflektohen rezultate sa më objektive. Formati/struktura e pyetësorit të studentëve përmban disa komponentë për të cilat duhet të shprehen ata: për pedagogun, për lëndën, për mënyrën e vlerësimit etj. Gjetjet, pasi përpunohen, analizohen me qëllim përmirësimin e cilësisë. Disa nga pikat e forta për të cilat janë shprehur studentët përmendim: korrektesa e personelit akademik, cilësia e mësimdhënies nga ana e tyre, etj. cilësinë e mësimdhënies dhe materialit të ofruar në silabus, literatura, etj. Kjo u konstatua edhe nga takimi me studentët e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezulton se, publikimi i rezultateve nga pyetësoret dhe gjithë procedurat që monitoronin cilësinë dhe performancën dokumentohen dhe bëhen të aksesueshme për të interesuarit.</p> <p>Rezultatet e vlerësimeve bëhen pjesë e raportit vjetor të NJZHKSC. (Evidencë 37)</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

	Në çdo rast, Departamenti, organizon mbledhjet respektive, për të diskutuar rreth gjetjeve pozitive ose jo, me personelin mësimdhënës.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Konstatuam që, NJZHKSC, zhvillon seminare informuese, trajnime të stafit akademik në lidhje me komponentët e ndryshëm të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie. Kjo përgjithësisht ndodh në fillim të vitit akademik. Përmes këtyre mekanizmave të vlerësimit (studentë, drejtuesi i departamentit) dhe rezultateve të nxjerra dhe që përpunohen nga NJZHKSC-ja, shihet dhe analizohet niveli i performancës në institucion. NJZHKSC, organizon trajnime tematike në lidhje me metodat e mësimdhënies apo në funksion të përmirësimit të cilësisë, sipas një kalendarit që hartohet në fillim të vitit akademik. (Evidencë Dok. Shtesë 9.11.12)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Konstatuam që, në plan programe janë të përcaktuara format e mësimdhënies, si leksioni, seminari, detyrat si ese, projektet mësimore. Këto janë pjesë e silabusit referuar specifikës që çdo disiplinë ka. (Evidencë 19) Format e vlerësimit të studentëve janë të mirë përcaktuara në çdo silabus. Vlerësimi përfundimtar merr në konsideratë të gjithë përbërësit e vlerësimit të studentëve, (provimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, seminarat, frekuentimin e lëndës etj.) dhe rezultatin e provimit përfundimtar sipas kriterëve të vlerësimit të kursit. Gjithashtu, si traditë e këtij institucioni është edhe organizimi i Javës së Orientimit (open days) ku me fillimin e vitit akademik, gjatë javës së parë të tij, Zyra e Dekanit për Studentët vë në dispozicion manualin orientues për studentët me të drejtat, detyrat e tyre, organizimin institucional, programin e studimit, ambientet, stafin akademik dhe ndihmës-akademik dhe administrativ përkatës, etj.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Konstatuam se, stafi akademik ishte mjaftueshëm i hapur me studentet dhe në gatishmëri për të ndarë me ta instrumentet dhe cilësinë e vlerësimit. Referuar natyrës së çdo lënde, në vlerësim marrin pjesë shumë faktorë. Pedagogu është i hapur të argumentojë me fakte vlerësimin e studentit. Nëse studenti nuk është prezent, ai ka mundësi që më vonë të kërkojë vlerësimin individual në departament. (Evidencë 7) Sekretaria informon studentët mbi vlerësimet që ata kanë marrë në lëndë të ndryshme gjatë vitit, por edhe në përfundim të semestrave.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike.	Konstatuam se, IAL mbështet mjaftueshëm stafin akademik, kjo në rrafshin etik dhe profesional. Stafi gëzon hapësirë të mjaftueshme në ushtrimin e lirisë akademike brenda disiplinës që mbulon. Stafi është i lirë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	të zgjedhë forma të metodologjisë së mësimdhënjes mjaft që të jenë në funksion të disiplinës dhe të përmbushin qëllimet dhe nevojat e studentëve. Trajnimi i stafit akademik është qëllim i IAL dhe Departamentit, por mbetet në tentative në këtë hapësirë kohorë prej dy vitesh, referuar dhe situatës pandemike.								
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Konstatuam se, stafi akademik që mbulon programin e studimit, është mjaftueshëm i përgatitur, me përvojë në fushën e mësimdhënies. Lektorët si dhe asistentët lektorë, përdorin metoda bashkëkohore ku ndërthurin pjesën e teknologjisë në mësimdhënie, kjo bazuar në specifikën e programit të studimit, ku përdoren teknikat më të fundit në këtë fushë.								
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Konstatuam që, IAL konsideron studentët pjesë integrale e vlerësimit, jo vetëm e planprogrameve dhe të politikave akademike, por edhe të përmirësimit të metodave të mësimdhënies nëpërmjet sugjerimeve dhe mendimit të tyre kritik në komisionet ad-hoc, në Departament dhe Senatit Akademik ku ata janë të përfshirë. (Evidencë Dok.shtesë 7)								
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Konstatojmë që, stafi akademik përdor metoda interaktive, stimuluese, si dhe kontrolli i dijes bëhet me shkrim dhe/ose me gojë, me detyra kursi dhe me dorëzim dosje. Vlerësimi bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 – 10, ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F, sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. (Evidencë 7)								
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Gjatë vizitës së GVJ-së në UniBa, personeli akademik theksoi se në leksione/seminare përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke kombinuar metodat tradicionale me ato bashkëkohore, në varësi edhe të natyrës dhe specifikave të lëndës, me qëllim interaktivitetin. Gjatë takimeve të realizuara me studentët dhe stafin, konstatuam se studentët stimulohen mjaftueshëm të mendojnë, arsyetojnë, krahasojnë fakte, arsyetime dhe të gjejnë zgjidhje optimale përgjatë përmbushjes së detyrave të kursit, apo detyra në disiplina të caktuara. Kjo i nxit studentët të përmirësojnë të menduarit kritik.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme

Konfirmojmë që, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve e zhvillon procesin akademik, në godinën qendrore e cila ndodhet në Rrugën “Frang


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

<p>dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Bardhi”, me një sipërfaqe prej 6451 m². (Evidencë 42a) Ambientet, janë sipas kushteve bashkëkohore të ndara në klasa dhe ambiente sportive, për zhvillimin e aktivitetit të edukimit duke plotësuar kërkesat specifike, për të ofruar këtë program studimi.</p> <p>Infrastruktura e universitetit përmban klasa me hapësira të mëdha, laboratorë të pajisur me mjetet e nevojshme teknologjike, auditorët të pajisura me video projektor dhe tryeza pune komode. Sallat dhe zyrat kanë të instaluar sistem kondicionimi ngrohje-ftohje, janë të pajisura me kompjuter, video projektor, ekrane të mëdha, flipcharte.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Konfirmojmë që, klasat janë të pajisura me mjetet audio vizive të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor efektiv, ku përfshihen kompjuteret personal (PC), video projektore, sistem fonie, sistem kondicionimi, internet wireless, etj. Gjithashtu, konstatuam se, IAL ka realizuar ndërtimin e ambienteve sportive specifike, në funksion të këtij programi studimi, ku zhvillohen rregullisht praktikat lëndore.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Në shërbim të të gjithë personelit akademik, komunitetit studentor, por edhe atij ndihmës, është në dispozicion një infrastrukturë e mjaftueshme IT, që mundëson komunikimin online, si dhe shfrytëzimin online të materialeve didaktike.</p> <p>Konfirmojmë që, institucioni ka vënë në dispozicion Laboratorin e Informatikës, me kapacitet prej afërsisht 30 personash, ku studentët e programeve respektive mund të përgatisin temën e diplomës në funksion të përmbylljes së programeve të studimit, apo të detyrimeve të tjera akademike, si psh. detyrat e kursit etj.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Konfirmojmë që, literatura e paraqitur në çdo silabus të programit mësimor dhe e sugjeruar nga personeli akademik përbëhet nga botime që përdoren në universitet.</p> <p>Literatura bazë, vënë në dispozicion të studentëve, zhvillohet në gjuhën shqipe. Në dispozicion të studentëve është literatura bazë në trajtën e leksioneve, dispensave, si edhe teksteve të miratuara në njësinë bazë. Literatura bazë për studentët e këtij programi gjendet në Bibliotekën e IAL. Në bibliotekë, konstatuam se, ka literaturë relativisht të mjaftueshme. Biblioteka ka të skeduar 62 tituj, tekste mësimorë, për Departamentin e Edukimit Fizik dhe Sporteve. (Evidencë Dok. Shtesë 14)</p> <p>Pjesë e bibliotekës janë libraritë online EBSCO, JSTOR, etj</p> <p>Përveç literaturës bazë, studentëve u sugjerohet edhe literaturë ndihmëse, e cila është përzgjedhur nga njësi bazë dhe është në gjuhën shqipe, angleze, apo edhe italiane. (Evidencë Dok. Shtesë 16)</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike të cilat u vijnë në ndihmë studentëve për të aksesuar bibliotekat on line që “UniBa” disponon. Biblioteka ka hapësira fizike të mjaftueshme studimi. Literatura e silabuseve, përgjithësisht, gjendet edhe në bibliotekën e universitetit. Qëllimi i institucionit është që kjo literaturë të pasurohet nga viti në vit me hyrje të reja, kryesisht në gjuhën shqipe.</p> <p>Salla e bibliotekës të universitetit, disponon një numër tavolinash dhe kënd leximi, me një hapësirë relativisht të kufizuar për të plotësuar kërkesat e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

	studentëve (20 vende), por u verifikua edhe disponibiliteti i dy ambienteve, në konceptin open space, për të krijuar mundësi leximi dhe shqyrtimi të teksteve.			
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, konstatuam që , UniBa kishte një kontratë me abonim periodik me bibliotekën online EBSCO dhe JSTOR. Në këto dy biblioteka, studentëve u ofrohej mundësia e shfletimit online dhe konsultimit të materialeve të ndryshme, lidhur me fushën e programit të studimit.			
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Konstatuam se , ekziston Laboratori i Informatikës, ndërtuar posaçërisht për studentët në mbështetje të detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike. Siç është përmendur, në funksion të studentëve është edhe laboratori i informatikës, me kapacitet prej rreth 30 personash. Ky laborator i shërben studentëve të UniBa-së në disa programe studimi, sipas një orari të përcaktuar dhe të ndarë për studentë të programeve të ndryshme. Kjo infrastrukturë i ndihmon studentët për përgatitjen e eseve/detyrave në lëndët e këtij programi studimi si dhe për temat e diplomave.			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Konstatuam se , Semestri i dytë i vitit akademik 2019-2020 dhe viti akademik 2020-2021 e sprovoi mësimdhënien online, për shkak të izolimit nga pandemia Covid – 19. Mësimi u zhvillua online, për të gjithë studentët e UniBa, në platformën Google Classroom dhe Google Meet. (Evidence 39a) Studentët e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, kanë ndjekur rregullisht leksionet, seminarët dhe kanë punuar detyrat e çdo disipline.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Gjatë vizitës në institucion, konstatuam se , personeli akademik dhe studentët kanë në përdorim adresat zyrtare të email-it nën logon e institucionit dhe komunikojnë dhe shkëmbejnë materiale në mënyrë elektronike. Po ashtu, edhe personeli administrativ ka në përdorim adresat e tyre të e-mail me domain të universitetit, duke lehtësuar komunikimin mes tyre, për efekt të njoftimeve të ndryshme, notave, vlerësimeve, detyrave, të kontakteve me sekretarinë mësimore etj.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studentët e programit, mentorohen nga momenti i përzgjedhjes së temës kërkimore deri në prezantimin dhe mbrojtjen e saj përpara jurisë. Departamenti përcakton një pedagog udhëheqës i cili duhet të mbajë të paktën gradën shkencore Doktor i Shkencave. Pedagogu udhëheqës dorëzon përpara komisionit “Formularin e udhëheqjes”, ku specifikon ecurinë e studentit të udhëhequr, për mbrojtjen e temës kërkimore, në rastin e studentëve me mesatare mbi 9.5. (Evidence 7) Studentët, të cilët nuk kanë mesatare 9.5 e sipër, zhvillojnë provimin përfundimtar.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Konstatuam që, njësia kryesore, strukturë e përherëshme në institucion dhe mbështur në rregulloren e institucionit, mbikëqyr zbatimin e planit të veprimit për të siguruar përmbushjen e rekomandimeve, për të përmirëuar mangësi të identifikuar. Për këtë i referohen pyetësorit që u zhvillohet studentëve, raportit të vetëvlerësimit të stafit akademik mbi programin e studimit. (Evidencë Dok. Shtesë 7)</p> <p>Në UniBa, funksionon Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë. Kjo strukture, zhvillon veprimtarinë e saj për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë bazuar në Rregulloren e NJZHKC, për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe programit të studimit në bashkëpunim me departamentin përkatës. (Evidencë 8)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit vlerësohet si thelbësor për Departamentin. Ky i fundit përdor të dhëna kualitative dhe kuantitative në vlerësimin e lëndëve të tij, programeve të studimit dhe mësimdhënies, duke përfshirë komente nga studentët dhe palët e interesuara për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta përgjatë përmbushjes së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti, ka në vëmendje ide dhe koncepte të reja, si një vlerë të shtuar në programin e studimit. Angazhohet të rekrutojë staf akademik me kualifikim në vendet perëndimore, duke pasuruar në këtë formë programet me metoda të reja mësimore dhe e-learning. (Evidencë 24)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni, në bashkëpunim me Departamentin dhe departamentet e tjera të UniBa, organizojnë Workshop-e, trajnime dhe aktivitete me tematika të ndryshme të mbajtur nga trajnues kombëtar dhe ndërkombëtarë në mënyrë që të përmisojnë: aktivitete e mësimdhënies dhe mësimnxënies. (Evidencë Dok. Shtesë 12)</p> <p>I gjithë personeli akademik, në përbërje të Departamentit të EFS, ka kryer kurse trajnimi afatshkurtër, afatmesëm, si edhe afatgjatë brenda dhe jashtë vendit me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Konstatuam që Institucioni, organizon trajnime të herëpashershme në bashkëpunim me departamentin dhe strukturat e tjera të UniBa, përmes trajnimeve të ndryshme tematike, tryezave të rrumbullakta, leksioneve të hapura etj., me qëllim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja nga ana e stafit akademik të departamentit. si psh. Përdorimi i Google Classroom për mësimin online, gjatë periudhës së pandemisë, si dhe leksioneve të hapura, etj. (Evidencë Dok. Shtesë 12)</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Konfirmojmë se: Lektor i lëndës përkatëse i referohet planit mësimor të programit të studimit si dhe në mënyrë të veçantë silabusit të lëndës përkatëse.</p> <p>Në fillim të vitit akademik, lektori i lëndës ka të drejtë të përmirësojë sillabusin e lëndës deri në masën 20%, por nuk e dëshmojnë këtë fakt.</p> <p><i>Gjithashtu, silabuset kanë problematika formatimi, në zbatim të akteve nënligjore në fuqi.</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe</p>	<p>Personeli akademik bën përpjekje të aplikojë metoda bashkëkohore në mësimdhënie, duke përdorur teknologjinë e informacionit që mundësohet edhe nga institucioni. Kjo lehtëson mësimdhënien në lëndë të caktuara dhe sipas specifikave të temave, e bën mësimin më interaktiv dhe më interesant</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al





<p>raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>për studentët. Këto elementë të mësimdhënies bëhen pjesë e analizës periodike të departamentit, si dhe pjesë e informacioneve që përgatit dhe raporton njësia (departamenti) apo edhe pjesë e raporteve institucionale. Lektorët inkurajohen të strukturojnë disiplinën në përputhje me dinamikën e tregut e të zbatojnë metoda të reja, në mënyrë që të përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndryshimi i vazhdueshëm i tendecave të tregut të punës - Sugjerime nga Agjencitë e Akreditimit - Sugjerime nga lektori i lëndës - Sugjerime nga studentët <p><i>Sa më sipër, ekziston koncepti i motivimit dhe inkurajimit, nga ana e institucionit, por nuk ka një reflektim në programet lëndore, nga ana e personelit akademik.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, herë pas herë, organizon aktivitete me karakter shkencor si leksione të hapura, konferenca shkencore, tryeza të rumbullakta etj. (Evidencë Dok. Shtesë 12)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>UniBa, ka hartuar dokumente rregullatore, transparente që normojnë kriteret, mënyrën e vlerësimit, si edhe njihen e tyre prej studentëve. Studentët njihen me procedurat e mësipërme nga titullari i lëndës gjatë momentit të prezantimit të silabusit. Rezulton se, ekzistojnë procedura transparente të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit përsa i përket vlerësimit dhe kontrollit të njohurive të studentëve. (Evidencë 7)</p> <p>Mënyra e kontrollit të njohurive është e përcaktuar edhe në silabusin e çdo lënde. Format e vlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provimi ndërmjetëm 20 pikë (20%); - Pjsëmarrja aktive në semirar 10 pikë (10%); - Ese / punë në grup 20 pikë (20%); - Provimi përfundimtar 50 pikë (50%).
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rezulton se, ekziston një praktikë e konfirmuar ku javën e parë të semestrit, studentët prezantohen nga pedagogu i lëndës me, (Evidencë 19):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetencat e lëndës - Përshkrimin e lëndës - Rezultatet e mësimnxënies - Metodatat e vlerësimit të lëndës - Literatura për zhvillimin e lëndës

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Rezulton se format kryesore të mësimdhënies në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, janë leksionet, seminarat, praktikat, detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme të semestrit si dhe provimet përfundimtare. Puna mësimore organizohet në bazë grupi, kursi dhe nëngrupi.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit, (seminare, testim përgjatë semestrit, ese, detyra kursi etj.), nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Rezulton se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provimi përfundimtar 50 pikë (50%) - Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%) - Pjesëmarrja aktive në seminar 10 pikë (10%) - Ese/prezantim/punë në grup 20 pikë (20%) <p>Kjo procedurë, ka bazë legjislative dhe i referohet rregullores së programit të studimit. Studentit i njihet de fakto e drejta e ankimimit në çdo rast. (Evidencë 7)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Rezulton se, Rregullorja e Institucionit eviton mundësinë për abuzime apo shmangie të natyrave të ndryshme. Ekziston një procedurë si vijon: Lektori një javë përpara datës së zhvillimit të provimit dorezon tezën për miratim pranë njësisë bazë,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtuesi i njësisë bazë bën miratimin, nënshkrimin, vulosjen dhe shumëfishimin e saj - Tezës së provimit të studentit në momentin që zhvillohet provimi i vendoset një kod i cili korespondon me emrin e studentit. <p>Pedagogu pasi bën korrigjimin e provimeve (jo më shumë se 7 ditë nga dita e zhvillimit të provimit) paraqitet në njësinë bazë ku bën të mundur çkodimin e provimeve dhe hedhjen e rezultateve në procesverbal. (Evidencë 5)</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rezulton se, përmbushja dhe mbikëqyrja e provimeve në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, kryhet nga komisioni i provimit, që propozohet nga departamenti dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. (Evidencë 5)</p> <p>Ky komision përbëhet nga tre pedagogë të departamentit i të cilët zotërojnë kompetencat e fushës/lëndës.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose</p>	<p>Rezulton se, mënyra e zhvillimit të provimeve është e parashikuar në rregulloren e Institucionit.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al




kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Provimet zhvillohen në mënyrë rigorozë si dhe institucioni siguron transparencë mbi mënyrën e kontrollit të njohurive.			
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Rezulton se, departamenti ka detyrimin, mbështetur në rregulloren e programit, të ofrojë komente, reagime tek studentët. Vlerësimi i njohurive mund të shoqërohet nga pedagogu përkatës me komente nëse shihet e nevojshme, për të sqaruar studentin si dhe për ta ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen. Kjo doli edhe nga kontakti me pedagogët gjatë vizitës në UniBa. Në takimin me ta, u përmend se pedagogu bën konsultime pas provimit, për t'i njohur konkretisht me vlerësimin. Po ashtu, kur kanë pasur ndonjë rast ankese, kanë bërë rishikim të vlerësimit dhe nëse ka qenë rasti edhe ka ndryshuar ky vlerësim. Ndërsa ngritje komisioni ankimimi, deri tani nuk ka pasur, sipas pedagogëve të pranishëm gjatë vizitës në UniBa. Gjithashtu edhe Rregullorja bën përcaktimin në lidhje me korrigjimin e tezave të provimeve, vlerësimin dhe rivlerësimin e tyre.			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregulloret institucionale dhe rregullorja e programit të studimit parashikojnë rregulla për zhvillimin e provimeve, ndalimin e kopjimit dhe të plagjiaturës. Gjithashtu edhe Manuali i Studentit tek pjesa mbi Standardet etike të sjelljes së studentëve parashikon ndër të tjera detyrimin e tyre për të respektuar etikën gjatë procesit mësimor, të mos bëjnë tentativa për mashtrim apo çënim të rregullave të procesit akademik, të mos paraqesin punime apo projekte si të tyret kur kanë dijeni se janë të dikujt tjetër etj. (Evidence 5)			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Konstatuam që, kontrolli i dijeve të studentëve konsiderohet proces dhe jo moment. Vlerësimi bëhet në të gjithë instrumentet, me gojë, me shkrim, me pikë me notë dhe konfidencial me studentin për çdo silabus (Evidence 19). Rregullorja, i njej stafit një afat të përcaktuar qartë, lidhur me vlerësimin dhe paraqitjen e rezultateve pranë sekretarisë mësimore. (Evidence 5)			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Konstatuam që, studenti, ka të drejtë të njihet me fletën e provimit pas korrigjimit ku bëhet edhe çsekretimi i tyre dhe me pikët totale të vlerësimit në tezë në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjura apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, gëzon të drejtën të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të degës përkatëse, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. (Evidence 5)			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Konstatuam që, Rregullorja e Institucionit dhe ajo e provimeve, pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyet e përmendura më sipër, nëse Drejtuesi i Departamentit, nuk gjen dot zgjidhje, i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Dekani, ngre komision <i>ad hoc</i> në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. (Evidence 5) Vendimi i bashkëlidhet procesverbalit (fletës së provimit) të provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Standardi III.7**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Në Rregulloren e Programit të Studimit janë përcaktuar qartë objektivat e këtij programi studimi, të cilat synojnë ofrimin e njohurive të përgjithshme dhe specifike, të mbështetura në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, si edhe plotësuese. Objektivi kryesor, është përgatitja e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe mesëm i lartë, <i>edhe pse duhet të artikullohet më qartë</i> , në mënyrë që të jenë të aftë që të integrohen në proceset e mësimdhënies. (Evidencë 7) Gjithashtu, gjatë bashkëbisedave me stafin dhe studentët konstatuam që: Stafi akademik kombinon leksionet tradicionale të përqëndruara në teori me: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje kritike për zgjidhjen e problemeve,- Studimet e rasteve- Analiza- Orë mësimore simuluese, etj.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Kompetencat profesionale që duhet të fitojnë ata në përfundim të programeve janë fjala kyç që mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset e programeve respektive. (Evidencë 7)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Rezulton se në përfundim të çdo semestri, stafi akademik dorëzon pranë njësisë bazë, raportin e vetëvlerësimit të pedagogut. Ky raport bën të mundur matjen e indikatorëve për realizimin me sukses të lëndës apo modulit përkatës. Në silabuset e çdo lënde studentët kanë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë, rezultatet e të nxënit, që marrin në lëndë. Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në lëndë mund të evidentohen përmes vlerësimit të studentit, në gjithë treguesit që ka ky vlerësim. Metoda e vlerësimit është ajo e vazhdueshme, gjatë gjithë semestrit ku zhvillohet lënda, nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me gojë dhe/apo shkrim. Vlerësimi final i referohet disa elementëve: vlerësimit përfundimtar, provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar, aktivizimit gjatë seminareve dhe ushtrimeve, si dhe detyrave të kursit, me pikëzimin e mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none">- Provimi përfundimtar 50 pikë- Provimi i ndërmjetëm 20 pikë- Pjesëmarrja aktive në seminare 10 pikë- Ese/prezantim/pune në grup 20 pikë
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Konstatuam që, Rregullorja e Programit parashikon të organizohen orë përsëritëse nga java e 7-të dhe 15-të, për çështjet, konceptet më të rëndësishme, shpjegohen, analizohen deri në fund të secilit leksion.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Konstatuam që, Gjatë gjithë vitit akademik, me aktivizimin dhe pjesëmarrjen e lektorëve dhe asistent lektorët, Departamenti dhe stafi kanë detyrimin për të realizuar orë mësimore të hapura si dhe seminare me tematika të ndryshme në formën e aktiviteteve ekstrakurikulare. (Evidencë 6b)</p>			
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Lëndët në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, në varësi të llojit dhe ngarkesës së tyre janë të organizuara në mënyra të ndryshme.</p> <p>Të gjitha këto lëndë i bashkon fakti që janë të ndërtuara mbi bazë kompetencash.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimin e leksioneve - Realizimin e seminareve - Punimin e ushtrimeve - Realizimin e projekteve apo detyrave të kursit etj. 			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga bashkëbiseda me studentët, konstatuam që, puna në grup është efikase dhe bëhet për çështje të veçanta. Pedagogët përfshijnë në planin e mësimit punë në grup, punë me projekte, të cilat kërkojnë një bashkëpunim midis studentëve. Kjo i ndihmon studentët të rrisin aftësitë e tyre bashkëpunuese, komunikuese dhe vetbesimin.</p>			
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Konstatuam që, stafi akademik, inkurajon në mënyrë të vazhdueshme studentët të marrin pjesë në konferenca dhe të publikojnë punimet e tyre në revista shkencore edhe me mentorimin e pedagogëve dhe rrjeteve të tyre akademike-shkencore, <i>por nuk konstatuam raste të botimit këto dy vitet e fundit.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Rezulton se, Departamenti, si dhe institucioni inkurajojnë studentët për të marrë pjesë dhe të përfshihen në botime shkencore, por, bazuar në evidencat e përcjella nga IAL, si dhe takimin me studentët, nuk rezultojnë punime të përbashkëta.</p> <p><i>Rekomandojmë, rritjen dhe intensifikimin e marrëdhënieve pedagog-studentë, lidhur me aktivitetin shkencor.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Konfirmojmë që, UniBa ka të shprehur dhe përcaktuar qartë, si në Rregulloren Institucionale si dhe në Statut, nevojën për mbështetje dhe bashkëpunim, në kuadër të marrëveshjeve, lidhur me mobilitetin e studenteve, por u evidentua që nuk kemi një mobilitet të studenteve, referuar programit të studimit.</p> <p><i>Rekomandojmë fuqizimin e këtij aspekti edhe në programin në fjalë, duke evidentuar rëndësinë që mobiliteti studentor ka, në kuadër të zhvillimit dhe përmirësimit të karrierës së tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitim të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Në funksion të përfitim të njohurive, njësitë përgjegjëse garantojnë mjedise brenda dhe jashtë institucionit për realizimin e praktikës profesionale të bashkërenduara me institucionet partnere ku studentët kryejnë këto praktika. (Evidence RVB). Orët e praktikës profesionale të programit Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”, kanë 12 ECTS dhe ekuivalentohen me 300 orë, 10% në totalin e ngarkesës së mësimdhënies të këtij program studimi. (Evidencë 14.2 & 7) Praktikat profesionale zhvillohen në institucione shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin pedagogut mentor të programit. (Evidencë 69)			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Rezulton se, ekzistojnë 88 marrëveshje me institucione arsimore parauniversitare, në të cilat zhvillohet praktika profesionale. Në këtë aspekt, sugjerojmë zgjerimin e marrëveshjeve me Zyrat Vendore Arsimore, për të patur një efikasitet më të lartë të zhvillimit të procesit si një menaxhim më cilësor të burimeve njerëzore. (Evidencë Dok. Shtesë 1)			
Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Orët e praktikës profesionale, kanë peshën që ofron ligji dhe ekuivalentohen me 300 orë në totalin e ngarkesës së mësimdhënies, duke përbërë elementin me peshën specifike përkatëse në procesin e formimit, në përputhje me objektivat e formimit dhe strategjinë zhvillimore të këtij programi. (Evidencë 7 & 14.2)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje të përgjithshme	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Konstatuam që, institucioni ka hartuar procedure të posaçme për provimin përfundimtar. Ky program studimi mbyllet me mbrojtjen e provës finale para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti për këtë qëllim, në rastet kur studentet kanë një mesatare 9.5. Ndërsa, në rastet kur studenti nuk ka një mesatare të tillë, e përfundon programin e studimit me provim përfundimtar. Kjo bazuar në rregulloren e institucionit, si dhe programit të studimit. Studentët njihen heret me këtë detyrim dhe hapat që duhen përmbushur. (Evidencë 7)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në	Konfirmojmë që, studentët kanë mbështetje të vazhdueshme nga stafi akademik për të përmbushur hap pas hapi provën finale.


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Për këtë, Departamenti, ka vënë në dispozicion të studentëve një manual udhëzues Paketa e Provës Finale. (Evidencë Dok. Shtesë 10)
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Konfirmojmë që, Paketa e provës finale ka në përmbajtjen e saj udhëzime për procedurat e përgatitjes, udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të provës finale. Po ashtu në paketë janë renditur përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie. Komisioni i vlerësimit të provës finale e mbështet punën e tij në procedurat e hollësishme të Paketës së provës finale. Kjo paketë i shërben si pedagogëve, ashtu edhe studentëve. (Evidencë Dok. Shtesë 10 & 5)
Kriteri 4. Personeli akademik orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Personeli akademik i programit të studimit MP në EFS, ka gjithnjë në gatishmëri orientuese një fond pyetjesh dhe temash që duhet të studiohen për provën finale. Po ashtu, ky staf mësimor dërgon për orientim tema punimesh, nga të cilat studentët përzgjedhin atë çka është në interesin e tyre kërkimor.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Konfirmojmë se, studentët që kanë fituar të drejtën për të bërë një tezë kërkimi (ata që kanë vendim senati, që përfunduar studimet me mesataren mbi 9,5 dhe që kanë paraqitur në kohën e duhur platformën e kërkimit të tyre) udhëhiqen nga një pedagog me gradën shkencore Doktor gjatë gjithë kërkimit të tyre. Ndihma u jepet si me material të ndryshme, ashtu dhe me mbështetjen për ngritjen e pyetjeve kërkimore, trajtimin e tyre, matjeve, etj që nevojiten për të kompletuar punimin. (Evidencë Dok. Shtesë 10 & 5)
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Konfirmojmë se, roli i udhëheqësit shkencor është i përshkruar me detaje në rregulloren akademike të UniBa. Udhëheqësi asiston studentin e tij në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre statistikor, shkrimin e temës , formatin, etj. Ai bëhet garant për punimin dhe cilësinë e rezultateve të nxjerra gjatë kërkimit duke referuar përpara Komisionit të Provës Finale nëse punimi është i plotë ose jo. (Evidencë 5)
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	E konfirmojmë se, gjithëshka ndodh konform udhëzuesit dhe në përmbushje të parimeve etike. Mbështetur në procedurën e diplomimit, (provim ose mbrojtje diploma) studenti që përfundon MP në EFS vlerësohet me notë dhe me kreditë. (Evidencë 7)
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Diploma, shoqëruar me suplementin është hapi i fundit. Studenti pajiset me diplomën, suplementin e diplomës, si dhe listën e notave të lëshuara nga UniBa dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit në Republikën e Shqipërisë, pastaj vijnë hapat e tjerë drejt licensimit deri në punësim, hapa për të cilët insitucioni vazhdon të jetë i informuar. (Evidencë Dok. Shtesë 9)
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Konstatuam që, në përfundim të studimeve, studenti merr një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar si dhe plan programet e plota për secilën kurrikul sipas kërkesës së tij. Ky fakt i shërben studentit në raste kur mund të ndjekë studimet në fusha të tjera të përafërta studimi, transferimi apo dhe programe të dyta studimi.
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Konfirmojmë që, Sekretaria Mësimore, menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve, që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në databaset e Sekretarisë Mësimore, si dhe në regjistrin themeltar të notave.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

	Sekretaria Mësimore arkivon dhe mban në dosje dokumentat e çdo studenti që është i regjistruar, është çregjistruar, si dhe të studentëve që kanë mbaruar studimet e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Konstatuam se, nga shqyrtimi i RVB, si dhe takimet fizike se institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas organigramës së UniBa në lidhje me strukturën analitike të FSHSTS, në rang njësie dhe personelin përkatës. (Evidencë 44.1) Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, (DEFS) mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit. <i>[Evidenca 11: Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerezore; Evidenca 44: Formati Dosjes personale të stafit]</i></p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Konstatuam se, DEFS në bashkëpunim me Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, harton dhe zbaton procedura specifike për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit që fillojnë me shpalljen e thirrjes online, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kriterëve të përcaktuara në bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të Rregullores së UniBa. Procedura e rekrutimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten nga çdo njësi bazë (departament) e fakultetit, në fillim të vitit akademik. Dekani i fakultetit ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, për të vijuar më tej me procedurat e konkurimit. Shpallja për vende vakante bëhet publike, ku thirrja pasqyrohet dhe në faqen web të universitetit. [Evidenca 53: Ligji Nr. 8012015, date 22.07.2015 Per arsimin e lartedhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republiken e Shqiperise; Evidenca 11: Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerezore]</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Rezulton se, çdo ndryshim në lidhje me nevojat e njësisë, propozohet nga DEFS, i dërgohet për miratim Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerezore, shoqëruar me arsyetimin përkatës. Më pas institucioni harton procedura e kritere specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. (Evidencë 11), (Evidencë 47) Procedura e rekrutimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten nga çdo njësi bazë (departament) e fakultetit, në fillim të vitit akademik dhe çdo semestër, duke dërguar kërkesën përkatëse Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerezore, e cila, pas konfirmimit nga Sekretari i Përgjithshëm fillojnë me shpalljen e thirrjes online, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kriterëve të përcaktuara në bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të Rregullores së UniBa. [Evidenca 11: Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerezore]</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të</p>	<p>Konstatuam se vlerësimi për përzgjedhjen e personelit realizohet nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, bazuar në propozimin e departamentit, e cila përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, kontratat, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore (Evidencë 11) Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DEFS. Bazuar në kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit (Evidencë 11)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, (Evidence RVB), si dhe takimi me Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore konstatuam që, institucioni zbaton procedura ligjore për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit të studimit.</p> <p>DEFS në bashkëpunim me Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, harton procedurat për shpalljen e thirrjes online, përgatitjes së komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kriterëve të përcaktuara në bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të Rregullores së institucionit. (Evidencë 5), (Evidencë 11).</p> <p>Rezultoni se institucioni është angazhuar për krijimin e mjedisëve të përshtatshme për personelin akademik e ndihmës akademik me sipërfaqe duke ndërtuar Kampusin e Ri. Siperfaqja për personelin akademik e ndihmës akademik është 320m². (Evidencë 42a & 42b)</p> <p>Evidenca 2: Statuti i Universitetit Barleti; Evidenca 5: Rregullore e Universitetit Barleti; Evidenca 11: Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Evidenca 11a: Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin të Performancës; Evidenca 42: Te dhena të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit/</p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Konstatuam se, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DEFS. Ajo arkivon dosjet përkatëse të personelit akademik, si dhe të marrëveshjeve të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit. (Evidencë 11)</p> <p>Stafi akademik është i angazhuar për kualifikim të vazhdueshëm profesional brenda dhe jashtë vendit. (Evidencë 43)</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka organizuar leksione të hapura, në kuadër të zhvillimit pedagogjik. (Evidence Dok. Shtesë 12)</p> <p>Evidenca 43: Lista e kolleferencave, Work shop, Trajnimeve 2015 +J</p>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional	<p>Konstatojmë se, institucioni është angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm, (Evidencë 43), dhe zhvillimin profesional të personelit për metodat inovative të mësimdhënies si dhe të përdorimit të teknologjive të reja si platforma Google Classroom, Google Hangouts Meet, etj. (Evidencë 39b)</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al



të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor.	Evidenca 43: Lista e konferencave, Work shop, Trajnimeve 2015 + Evidenca 46: Udhezues ne nivel institucional per zhvillimin dhe perdorimin e metodave te ndryshme innovative te mesimdhënies ne baze te fushes se studimeve, lendeve/ dhe moduleve			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Institucioni dhe DEFS, dëshmojnë të kenë burimeve njerëzore të përshtatshme për përmbushjen e objektivave të programit të studimit Master Profesional Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte (<i>Evidencë 23 & 25</i>) dhe mjedise të përshtatshme për krijimin mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale (<i>Evidencë 42b</i>). DEFS, në çdo fillim viti akademik, planifikon paraprakisht ngarkesën mësimore për çdo anëtar të personelit akademik të departamentit si dhe ndjekjen e politikave për rekrutimin e pesonelit të nevojshëm për plotësimin e objektivave mësimore të këtij program studimi. [Evidenca 24: Te dhena tabelore per personelin akademik ne programin e studimit; Evidenca 42: Te dhena te plota per infrastrukturen			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Neë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e njafuëshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita e mjediseve të institucionit konstatoam se, lëndët e programit Master Profesional Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte zhvillohen në Kampusin e ri 2 të Universitetit Barleti. (<i>Evidencë 42a</i>) Infrastruktura e universitetit përmban auditore me përmasa të mëdha dhe me kushte të mira fizike. (<i>Evidencë 42b</i>) Të gjitha auditorët janë të pajisura me kompjuter dhe video-projektorë si dhe ekrane, të cilët mundësojnë mësimdhënien me metoda të ndryshme si power-point, imazheri etj. Auditorët gjithashtu janë të pajisur me mjetet e nevojshme didaktike, për të zhvilluar veprimtaritë mësimdhënëse teorike dhe praktike. Infrastruktura e universitetit përmban auditore me përmasa të mëdha dhe me kushte të mira fizike. (<i>Evidencë 42b</i>) Evidenca 42, 42a, 42b: Te dhena te plota per infrastrukturen
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Konstatoam se disa nga mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. FSHSTS ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve të programit Master Profesional Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, duke përmbushur kështu standardet e duhura 7.08 M2 për student. (<i>Evidencë Vizita e GVJ-së në UniBa 42a & 42b</i>)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Email: info@ascal.al

	[Evidenca 42: Te dhena te plota per infrastrukturen			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita e mjediseve konstatojm se, auditorët mësimorë janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banga, karrike, pajisje audiovizive, tabela etj.). Sallat e leksioneve në të cilat zhvillohen lëndët e programit të studimit janë të pajisura me videoprojektorë. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion konstatojm se mjediset mësimore si zyra, salla leksionesh, laboratorë, sallë konferencash janë të pajisuara me mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve që ofron ky program studimi për aftësimin teorik dhe detyrat praktike formues të programit të studimit.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Kriteri 4. UniBa ka aktualisht dy laboratore të teknologjisë së informacionit, të cilat janë të pajisur me programe profesionale. Krahas lëndës së teknologjisë së informacionit studentet bëjnë lëndën e kërkimit sasiorë në laborator ku janë të instaluar programet e nevojshme, si Excel dhe SPSS. Nderkohe, të gjitha klasat janë të pajisura me projektor, kompjuter / lap top dhe internet me lidhje fikse dhe wi fi.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të porsaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Nga vizita në terren, konstatojm se, laboratorit i informatikës është i pajisur me softuerët përkatës në mënyrë që të t'ia shërbejë sa më mirë programit mësimor me një kapacitet prej 30 vëndesh. Ai është në parametra të mirë për realizimin e nevojave të programit të studimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Laboratori, rezulton se shërben për zhvillimin e detyrave të kursit të studentëve, por edhe për aktivitete të ndryshme nga vetë departamenti. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të UniBa-së gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik. (Vizita e GVJ-së në UniBa) [Evidenca 42: Te dhena te plota per infrastrukturen; Evidenca 34: Marreveshjet e bashkepunimit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedisë mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedisë të porsaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion konstatojm se, biblioteka është e konceptuar në disa mjedisë të ndërlidhura së bashku. Një mjedis ku janë vendosur librat universitarë, me dy ulëse me pajisje teknologjike e lidhur me një open space, si dhe 18 ulëse leximi ku studentët kanë mundësi të ulen dhe të shfrytëzojnë literaturën. (Evidencë 42a) Gjithashtu një mjedis tjetër i hapur, vendosur në godinën 2, është konceptuar si sallë qendrimi dhe leximi për librat artistikë. (Evidencë 42a)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Email: info@ascal.al




	<p>Gjate vizitës, konstatoam që, biblioteka nuk funksionon me kartelë regjistrimi, por vetëm me kërkesa online të studentëve të cilët paraqesin kërkesën e tyre për shfytëzimin e librave.</p> <p>Studentët kanë të drejtë të regjistrohen dhe të përdorin literaturën e nevojshme në mjediset e bibliotekës, si dhe të tërheqin gjithashtu literaturë për shfytëzim jashtë mjediseve të bibliotekës.</p> <p>Evidenca 42: Te dhena te plota per infrastrukture.</p>			
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, rezulton se, biblioteka ka në dispozicion një fond librash me 60 tituj fizikë, lidhur me programin e studimit Master Profesional Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte në gjuhë shqipe. Gjithashtu, bazuar në marrëveshjet me bibliotekat dhe database ndërkombëtare, disponohet një akses i nevojshëm, për botimet në gjuhë të huaj, lidhur me programin e studimit, duke plotësuar rekomandimin e lënë nga akreditimi i mëparshëm.</p> <p>Evidenca 45, 42c: Lista e teksteve periodike ne Biblioteke</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatoam se, menaxhimi i librave të bibliotekës realizohet nëpërmjet platformës online për të krijuar kushte për akses të shpejtë, të barabartë e pa pagesë për studentët. (Evidencë Dok. Shtesë 16)</p> <p>[Evidenca 42d: Te dhena te plota per platformat online Bibliotekes]</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Rezulton se, institucioni ka krijuar mundësi për aksesim e studentëve në platformën on-line të bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfytëzimin e librave fizik dhe digjital. (Evidencë Dok. Shtesë 16)</p> <p>Institucioni, i ofron studentëve, nëpërmjet linqeve që gjenden në platformë, akses në bibliotekat online ndërkombëtare si: Econbiz, JSTOR, Research4life me të cilën institucioni ka edhe një marrëveshje bashkëpunimi. (Evidencë Dok. Shtesë 16)</p> <p>Evidenca 45: Lista e teksteve I periodike ne Biblioteke</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Rezulton se, institucioni ka krijuar mundësi për aksesim e studentëve në platformën on-line të bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfytëzimin e librave fizik dhe digjital. (Evidencë Dok. Shtesë 16)</p> <p>Institucioni, i ofron studentëve, nëpërmjet linqeve që gjenden në platformë, akses në bibliotekat online ndërkombëtare si: Econbiz, JSTOR, Research4life me të cilën institucioni ka edhe një marrëveshje bashkëpunimi. (Evidencë Dok. Shtesë 16)</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Gjatë vizitës, konstatoam që, biblioteka nuk funksionon me kartelë regjistrimi, por vetëm me kërkesa online të studentëve të cilët paraqesin kërkesën e tyre për shfytëzimin e librave biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve orare shërbimi, për të qënë në dispozicion të nevojave të studentëve.</p> <p>Biblioteka punon gjatë orarit 08:00-16:00 nga e hëna në të premtë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al



Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se, UniBa përdor sistemin Portali Studentor. <i>(Evidencë 48b1)</i> Gjithashtu konstatohet që sekretaria mësimore disponon statistika vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit; • të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik; • të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet; • të dhëna për ecurinë akademike të studentit; • numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen. <p>[Evidenca 46: Udhezues për përdorimin e Strukturaes se teknologjise se Informacionit]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar në Raportin Vjetor të DEFS, rezultojnë se, institucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik. <i>(Evidencë 24, 25, 37 dhe 43)</i> Ndërsa në listën e marrëveshjeve në funksion të programit të studimit shprehet qartë aktiviteti që institucioni ka, në rang njësie kryesore dhe njësie bazë me partnerët të cilët janë të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi siç janë 88 institucione të arsimit parauniversitar, në rang vendi. <i>(Evidencë 32)</i> Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. [Evidenca 46: Udhezues për përdorimin e strukturaes se teknologjise se informacionit]</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mësimore, konstatohet se, ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në formatin e Regjistrimit Themeltar të Studentëve dhe Regjistrimit të Diplomimit. <i>(Evidencë 9)</i> [Evidenca 46: Udhezues për përdorimin e Strukturaes se Teknologjise se informacionit]</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit Portali Studentor <i>(Evidencë 48b1)</i>, rezultojnë se, institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u japin të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata të aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti. Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj. <i>(Evidencë 9)</i> [Evidenca 46: Udhezues për përdorimin e Strukturaes se Teknologjise se Informacionit]</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al




Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Nëpërmjet Planit Stategjik të Institucionit UniBa, (<i>Evidencë 3</i>) dhe të dhënave për konferencat dhe trajnimet (<i>Evidencë 43</i>), rezulton se, institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrative, si dhe të monitorimit të hedhjes në kohë të dokumentacionit të kërkuar lidhur me përmbushjen dhe zhvillimin e aktiviteteve mësimore.		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Konfirmojmë që, në faqen zyrtare të internetit të UniBa janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendari akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UniBa, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Konstatojmë që, institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar i cili miratohet nga Senati akademik dhe Administratori, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i tarifës së shkollimit. (<i>Evidencë 50 & 50a</i>). UniBa, harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport, pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operationale dhe të mirëmbajtjes, etj. [Evidenca 50: Te dhena nga Plani i Financimit te programit te studimit]
Kriteri 2. Plani i financimit të një progra studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin literaturës e aksesin në bibliotekat on-line detyrimet financiare, grantet vendëse apo huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Konfirmojmë që, institucioni ka paraqitur një plan financiar për këtë program studimi, por, në Planin e Analizës së Tregut të Punës, për këtë program studimi, trajtohet teorikisht, tangent, raporti kosto/përfitime, pa përcaktuar vlerat e këtij raporti. (<i>Evidencë 16</i>) <i>Rekomandojme që: Institucioni të hartojë planin financiar të Programit të studimit Master Profesional Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, ku të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</i> Evidenca 49: Raportifinanciar vjetor UniB Evidenca 50: Te dhena nga plani ifinancimit te programit te studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al




	Evidenca 50a: Burimet Financiare UniBa Evidenca 50b: Raport i audituesve te pavarur dhe pasqyrat			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Nga shqyrtimi i RVB rezulton se, procedura për hartimin dhe miratimin e projekt buxhetit afatmesëm fillojnë në gjysmën e dytë të vitit akademik, pasi janë marrë parasysh nevojat e njësive kryesore të institucionit (<i>Evidencë RVB</i>). [Evidenca 50b: Raport i audituesve te pavarur dhe pasqyrat financiare 2019]			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Konstatohet se, në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni dokumenton raportin financiar për 1 vit kalendarik lidhur me bilancin e vënë në dispozicion, në rang IAL-je, edhe mbi bazën e programit të studimit, (<i>Evidencë 49 dhe 50</i>), por është i rëndësishëm edhe pasqyrimi lidhur me kërkesat e tregut të punës, bazuar mbi analizën përkatëse. Evidenca49: Raporti financiar vjelor UniBa; Evidenca 50: Te dhena nga Plani i Financimit te programil Master Profesional ne Mesuesi ne Etlukim Fizik dhe Sporle			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Konstatohet se, bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni, (<i>Evidencë 49</i>), dëshmon se UniBa garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program studimi. [Evidenca 49: Raporti financiar vjetor UniBa]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që	Rezultoni se, institucioni zbaton politika për kriteret e pranimit dhe transferimit bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

<p>mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në Udhëzim Nr.15, datë 26.05.2020, Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar si dhe Udhëzim Nr. 17, datë 30.07.2019 “Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 11, datë 02.06.2021 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>[Evidenca 2: Statuti i Universitetit Barleti; Evidenca 5: Rregullore e Universitetit Barleti; Evidenca 7: Rregullore e Programit Master Profesional ne Mesuesi ne Edukim Fizik dhe Sporte; Evidenca 53: Ligji i Arsimit te Larte; Evidenca 55.1: Vkm Nr.41 dt.24.01.18</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet që, institucioni ka ngritur komisionet përkatëse, pranë departamentit, ku nëpërmjet Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve ka hartuar politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student, në këtë program studimi. (Evidencë 7 & 9)</p> <p>Konfirmohet që, procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.</p> <p>Evidenca 2 Statuti i Universitetit Barleti; Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Barleti; Evidenca 7 Rregullore e Programit Master Profesional ne Mesuesi ne Edukim Fizik dhe Sporte.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Rezulton se, përpapa fillimit të çdo viti akademik institucioni, me propozim nga DEFS dhe miratim nga Senati Akademik, harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, duke garantuar shanse të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare, si dhe personat me aftësi të veçanta.</p> <p>Evidenca 65: Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Konstatohet se, institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UniBa, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online.</p> <p>UniBa, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit Master Profesional ne Mesuesi ne Edukim Fizik dhe Sprte.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Rezulton se, institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi. (https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-mesuesi-ne-edukim-fizik-e-sporte.html)</p> <p>Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al



	Në faqen e internetit të UniBa, gjendet në çdo kohë “Broshura UniBa”. https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/BROSHURA_UNIBA_22-PRILL-2021.pdf		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Konstatohet që, programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit.</p> <p>Ato janë të publikuara në faqen e internetit të UniBa, sipas fakulteteve përkatëse (https://fshsts.umb.edu.al)</p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UniBa dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. (<i>Evidencë 65</i>) • Rregullorja e Programit të Studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. (<i>Evidencë 7</i>) • Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit. (<i>Evidencë 19</i>) • Kurrikulën e Programit të Studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”. • Kalendari akademik në të cilën përcaktohen datat e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura, diplomimet etj. (https://umb.edu.al/kalendari-akademik.html) <p>Evidenca 72: Per llogaritjen e krediteve dhe shpërndarjes se kohes mesimore ne SHLUJ UMBJ</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	Nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik, si dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UniBa dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al



	<p>pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. Evidenca 5: Rregullore e Universitetit Barleti; Evidenca 7: Rregullore e Programit Master Profesional ne Mesuesi ne Edukim Fizik dhe Sporte; Evidenca 65: Manualin Rekrutim, Aplikim Rregjistrim, Transferim.</p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësi të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Konstatojmë se, bazuar në Rregulloren e UniBa, (Evidencë 5), në Manualin e Studentit, (Evidencë 65), si dhe silabuset, (Evidence 19) e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësi të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”. Evidenca 7: Rregullore e Programit Master Profesional ne Mesuesi ne Edukim Fizik dhe Sporte</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit “Master Proesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, (Evidencë 7), janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit në këtë program studimi. Në fillim të semestrit të dytë, studentëve u vihet në dispozicion paketa e punimit per hartimin e temës së diplomës. [Evidenca 14.1, 14.2: Kurrikula e Programit Master Profesional ne Mesuesi ne Edukim Fizik dhe Sporte]</p>		
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, si dhe vizitat në institucion, u informuam se DEFS, në fillim të vitit të parë të studimeve në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, organizon javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet infomacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Konstatojmë që, nëpërmjet “Manualit të Studentëve”, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. (Evidencë 65) Komunikimi i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet Portali Studentor, (Evidencë 48.b1), si dhe Google Classroom. (Evidencë 48.c2) Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me kurrikulën e programit të studimit, lëndët/modulet dhe ngarkesat përkatëse, silabuset dhe format e vlerësimit për secilën, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

	Evidenca 7. Rregullore e programit te studimit Master Profesional ne Edukim Fizik dhe te Sporte			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rezulton se, në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale udhëzuese si Manuali i Studentit, dhe Rregullorja e Programit të Studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura përcaktohen gjithashtu edhe në Strukturën e Vitit Akademik dhe si të tilla ruhen në sistem dhe u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik, të cilat publikohen në faqen zyrtare të UniBa. [Evidenca 14.1, 14.2: Kurrikula e Programit Master Profesional ne Mesuesi ne Edukim Fizik dhe Sporte; [Evidenca 48a, 48b, 48!, 48cl, 48c2, 48d, 48fl, 48/2, 48j3Udhezues per perdorimin e metodave inovative ne mesimdhenie			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Konstatohet se, Zyra Karrierës dhe Alumnit, informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale, të tregut të punës, duke kryer edhe trajnime për të diplomuarit dhe informimit të tyre për kërkesat e tregut, lidhur me programin e studimit. (Evidencë Dok. Shtesë 9.11.12)			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Çdo fillim të vitit të parë të studimeve, DEFS, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, organizojnë javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. (Evidencë 51) Në faqen e internetit të UniBa, gjithashtu gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UniBa dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, laboratorët etj. Evidenca 46, 46.1: Udhezues per perdorimin e Struktures se Teknologjise se Informacionit			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Konstatohet se, informimi i studentëve, realizohet nëpërmjet Portali Studentor, (Evidencë 48.b1), si dhe Google Classroom, (Evidencë 48.c2), sikurse pohan edhe vetë studentët gjatë takimit fizik, arrijnë të ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor. Ndërsa informacioni mbi kurrikulat e studimit, aktivitetet dhe kalendarin mësimor publikohen online dhe janë lehtësisht të arritshëm nga studentët në distancë. Evidenca 14.1, 14.2: Kurrikula e Programit Master Profesional ne Mesuesi ne Edukim Fizik dhe Sporte Evidenca 48a, 48b, 481, 48cl, 48c2, 48d, 48/1, 48j2, 48j3Udhezues per perdorimin e metodave inovative ne mesimdhenie Evidenca 46.1: Udhezues per perdorimin e Struktures se Teknologjise se Informacionit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Programit, (<i>Evidencë B</i>), konstatohet se, institucioni paraqet raporte vjetore për veprimtarinë e kryer. Konstatohet, gjithashtu, që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për secilin program studimi që UniBa ofron, specifiku për Programin e Studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, rezultojnë të regjistruar:</p> <p>2018/2020 janë 122 të regjistruar plus 1 i transferuar. 2019/2021 janë 93 të regjistruar plus 12 të transferuar. 2020/2021 janë 85 të regjistruar plus 9 të transferuar. 2021/2022 janë 126 të regjistruar plus 1 i transferuar.</p> <p>Ne total 461 të regjistruar</p> <p>Evidenca 27: Te dhena te plota per regjistrimin, ecurine, diplomimin e studenteve sipas viteve akademike, norta mesatare ne hyrje dhe dalje.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe Rregullorja e UniBa, (<i>Evidencë 5</i>), rezulton se, Sekretaria Mësimore është zyra e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët.</p> <p>Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore konstatojmë se, ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalje, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Evidenca 28: Te dhena tabelore permbledhe per transferimet e studimeve nga studentet.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion me përfaqësues të Zyrës e Karrierës dhe Alumnit (ZKA) konstatojmë se, ajo mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. (<i>Evidencë 69</i>)</p> <p>Rezultoni se ZKA, bazuar edhe në Rregulloren e ZKA, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike, mobilitet studentor si dhe informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo/edhe aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, nëpërmjet edhe trajnimeve që kryen me të diplomuarit.</p> <p>Evidenca 27: Te dhena te plota per regjistrimin, ecurine, diplomimin e studenteve sipas viteve akademike, nota mesatare nehyrje dhe dalje.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga takimi në IAL, konstatojmë se, sekretaria mësimore, disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu, ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, transferimet dhe regjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen, përfshi edhe temën e diplomimit.</p> <p>Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në platformën digjitale.</p> <p>Evidenca 48c: Portali studentor</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të</p>	<p>Konstatohet se, institucioni harton në mënyrë periodike raporte vjetore në rang IAL-je, për veprimtarinë e kryer. (<i>Evidencë 38</i>)</p> <p>Sekretaria Mësimore, gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al




studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalëse, si dhe punësimit të tyre. (Evidencë Dok. Shtesë 6 & 9) Evidence 38: Analize e Departamentit pergjegjes mbi arritjet e objektivave formuese te programit te studimit dhe rezultateve.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Konstatohet që, studentët e UniBa janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senat Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në NjZHKC. (Evidencë Plan i punës i NjZHKC) Evidence 30: Te dhena tabelore per njesite, individet, studentet dhe pale tejera te angazhuara ne NJSBC
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Rezulton që, institucioni është i angazhuar që të garantojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve në Senat Akademik, në grupin e ngritur nga NjZHKC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë. (Evidencë Plan i punës i NjZHKC). Gjithashtu, një nga strukturat e ngritura në UniBa është edhe Këshilli i Studentëve. Evidence 68: Perberja e GVBJ
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave burokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Rezulton se, institucioni gjatë hartimit të programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” ka respektuar Ligjin Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM nr. 41/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, duke iu përmbajtur ngarkesës mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, jo më shumë se 25 orë mësimore në javë. (Evidence 14 & 14.2) Sasia mesatare e punës së kryer gjatë Programit të Studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, është 60 kredite ose 1500 orë mësimore punë të studentit për çdo vit akademik. Në Programin e Studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, studentët zhvillojnë 933 orë në auditor dhe 2067 orë punë të pavarur. Evidenca 65: Manualin Rekrutim, Aplikim Rregjistrim, Transferim
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe	Rezulton se, përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes pyetësorëve të studentëve. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, kryen anketime cdo semester, cdo vit me secilin grup, të cilët i shërbejnë cilësisë së mësimdhënies. Studentet njoftohen për rezultatet e vlerësimeve të tyre per

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


<p>reflekon sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>ceshtje te perrniresimit te kurrikulave dhe te mesimdhënies. Rezultatet e pyetësorëve përdoren nga njësia dhe pedagogët përkatës për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien. Bazuar në këto vlerësime janë bërë ndryshime në kurrikula dhe përmirësime të niveleve të shërbimit.</p> <p>Evidenca 52: Manuali i hartimit te programeve te studimit dhe ndryshimit te programeve ekzistuese; Evidenca 13: Rregullore e zyres se monitorimit te kurrikules; Evidenca 8: Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise</p>		
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nëpërmjet instrumenteve matës për vlerësimin e procesit mësimor, nga stafi akademik, si dhe pyetësori për studentët (<i>Evidencë 37</i>), studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.</p> <p>Evidenca 5: Rregullore e Universitetit Barleti, Neni 88.</p>		
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve të problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Konstatohet se institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, Zyra e Dekanit të Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës si dhe Koordinatorit të Departamentit.</p> <p>Gjithashtu jashtë çdo departamenti ekziston këndi i informimit dhe njoftimeve që departamenti përkatës afishon.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit angazhohet në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve master. Zyra e Dekanit të Studentëve u vë në dispozicion atyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do ndjekin. Në ndihmë të këtij procesi, studentëve u vjen edhe informacioni që përmban Manuali i Studentit.</p> <p>Evidenca 9: Rregullore per Funkionimin e Sekretarise Mesimore; Evidenca 12: Rregullore e Funkionimit te Zyrave ne Sherbim te Studenteve prane UNIBAJ</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që</p>	<p>Studentët marrin informacion në mënyrë të drejtëpërdrejtë por dhe nga internet, në burime të ndryshme. Studentët në UniBa mund t'i drejtohen Sekretarisë Mësimore dhe Koordinatorit të Departamentit për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Ata mund t'i drejtohen Dekanit të Studentëve dhe Zyrës së Alumnit dhe Karrierës, për të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al



kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	marr informacion dhe këshillim për aktivitete e shërbime mbështetëse brenda dhe jashtë UniBa për, mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Konstatojmë se, studentët në UniBa u ofrohet informacion për karrierën duke ju drejtuar zyrës së Alumnit dhe Karrierës. Dekani i Studentëve dhe Zyra e Alumnit dhe Karrierës, në bashkëpunim të vazhdueshëm me departamentet, lehtësojnë të gjithë studentët për shërbimin e këshillimit të karrierës. Gjithashtu studentët orientohen për institucionet ku mund të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale, nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogut të përcaktuar për të mbikeqyrur lëndën e praktikës profesionale të parashikuar në planin mesimor të këtij programi studimi. Grupi Barleti ka një rrjet të gjerë strukturash të fokusuara në kërkim shkencor dhe në aktivitete që lehtësojnë angazhimin dhe ndërveprimin e studentëve me punëdhënësit e ardhshëm si BTTC dhe AM-Barleti Human Capital. Evidenca 12: Rregullore e Funkcionimit te Zyrave ne Sherbim te Studenteve prane UN/BA; Evidenca 5: Rregullore e Universitetit Barleti			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e Alumnit dhe Karrierës në UniBa mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve jo vetëm në UniBa por edhe në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale, etj. [Evidenca 12: Rregullore e Funkcionimit te Zyrave ne Sherbim te Studenteve prane UNIBA;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e	Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

<p>Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>rezulton se, institucioni ka hartuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. <i>(Evidencë 8)</i></p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UniBa bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë ngritur me Vendim të Senatit Akademik të UniBa. UniBa, ka një organizim strukturor të brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë, si dhe ka përcaktuar modalitetet dhe procedurën përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe ndjekja periodike e vlerësimit të veprimtarive të kryera akademike dhe shkencore, në përmbushje të standardeve të kërkuara. Ky sistem, përbëhet nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. <i>(Evidencë 2 & 5)</i></p> <p>Gjithashtu, në nivel institucional funksionon Komisioni për Vlerësimin e Performancës. <i>(Evidencë 11.a)</i></p> <p>Evidenca 8: Rregullore e NJSBC</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Konstatohet që, institucioni ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë, <i>(Evidencë 2 & 5)</i>, dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. <i>(Evidencë 3)</i></p> <p>Evidenca 3: Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Konstatohet që, institucioni ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë, <i>(Evidencë 2 & 5)</i>, dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. <i>(Evidencë 3)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Rezulton se, institucioni ka hartuar politika dhe procedura të qarta dhe periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Disa nga këto procedura periodike janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësor i stafit akademik për matjen e cilësisë të procesit mësimor, <i>(Evidencë 41)</i> - Pyetësor për studentët për matjen e cilësisë të procesit mësimor, <i>(Evidencë 40)</i> - Raportet analitike të vlerësimit të brendshëm që institucioni harton, <i>(Evidencë 35)</i> - Raport i vetëvlerësimit të programit të studimit, <i>(Evidencë B)</i> <p>Analiza vjetore e punës kërkimore shkencore nga ana e institucionit, në rang departamenti, <i>(Evidencë 43)</i></p> <p>Evidenca 8: Rregullore e NJSBC</p> <p>Evidenca 13: Rregullore e zyrës njesise se monitorimit te Kurrikules</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Standardi VI.2			
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Konstatohet se, vlerësimet e realizuara për elementë të caktuar të programeve të studimit në mënyrë periodike, çdo vit akademik, pasqyrohen në raportin vjetor të njësive bazë, (Evidencë 35) si dhe në Raportin e Vetëvlerësimit të programit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”. (Evidencë B) Evidenca 5: Rregulloren e Universitetit Barleti		
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet hartimit periodik të raportit të vlerësimit të brendshëm, i cili përfshin analizën e objektivave të programeve të studimit që UniBa ofron, metodat e mësimdhënies, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe format e vlerësimit. (Evidencë 13 & 38)	Rezulton se, institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet hartimit periodik të raportit të vlerësimit të brendshëm, i cili përfshin analizën e objektivave të programeve të studimit që UniBa ofron, metodat e mësimdhënies, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe format e vlerësimit. (Evidencë 13 & 38) Evidenca 13: Rregullore e zyres njesise se monitorimit te Kurrikules; Evidenca 5: Rregullore e Universitetit Barleti		
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në rang Institucional (Evidencë B) dhe Raportit të Vlerësimit në rang Departamenti (Evidencë 35), rezulton se, institucioni përdor instrumente matës dhe metodologji vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. [Evidenca 38 Analize e Departamentit te Edukimit Fizik dhe Sporte mbi arritjen e objektivave formuese te programit Master Profesional ne Edukim Fizik dhe Sporte.		
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nëpërmjet instrumenteve matës për vlerësimin e pyetësoreve për matjen e cilësisë së procesit mësimor, rezulton se, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana e pedagogut përgjegjës. Pas analizës e të dhënave përkatëse të dërguar nga institucioni rezulton se të dhënat e rezultateve u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Evidenca 38: Analize e Departamentit te Edukimit Fizik dhe Sporte mbi arritjen e objektivave formuese te programit Master Profesional ne Edukim Fizik dlte Sporte dhe rezultateve te pritshme te te nxenit dhe aftesimit profesional.		
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Nga shqyrtimi i Plani Strategjik i Departamentit, rezulton se, institucioni ka përfshirë analizën SWOT, gjatë së cilës trajtohen rezultatet e vlerësimit, rezultatet e pritshme, mangësive dhe pritshmëritë për përmirësimin në vijim të cilësisë. Evidenca 38 Analize e Departamentit te Edukimit Fizik dhe Sporte mbi arritjen e objektivave formuese te programit Master Profesional ne Edukim Fizik dhe Sporte dlte rezultateve te pritshme te te nxiinit dhe aftesimit profesional.		
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Shkalla e përbushjes së standardit				X
------------------------------------	--	--	--	---

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Nga shqyrtimi i RVB rezulton se, çdo vit akademik, në mënyrë periodike, hartohet Plani Strategjik i njësisë bazë (<i>Evidencë 4</i>), në të cilin pasqyrohen porpozimet për ndryshimet plan programeve dhe elementëve të tjerë të programeve të studimit që DEFS ofron dhe ia përcjell për miratim Senatit Akademik. Të gjitha këto ndryshime pasqyrohen te Strategjia e Zhvillimit Institucional. (<i>Evidencë 3</i>) Konstatohet, gjithashtu se DEFS kryen në mënyrë periodike Raportin e Vetëvlerësimit të Programit të Studimit. (<i>Evidencë 38</i>)
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme si: <ul style="list-style-type: none"> - Analiza e punës kërkimore shkencore në rang departamenti (<i>Evidencë 38</i>), - Strategji e Sigurimit të Cilësisë, (<i>Evidencë 37</i>) - Plani strategjik i UniBa, (<i>Evidencë 3</i>) Plani Strategjik i programit të studimit, (<i>Evidencë 4</i>)
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Rezulton se, institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si: <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga stafi akademik (<i>Evidencë 41</i>) - Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët Raportin e Vetëvlerësimit të Programit të Studimit Master Profesional Mësuesi Edukim Fizik dhe Sporte. (<i>Evidencë 38</i>) Evidenca 37: Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në	Intitucioni realizon në mënyrë periodike dy pyetësorë 1) me studentët dhe 2) me stafin akademik: 1.Për vlerësimin mësimdhënies nga stafi akademik (<i>Evidencë 41</i>) 2.Për vlerësimin mësimdhënies online nga studentët <i>Rekomandojmë që institucioni të zhvillojë sondazhe, fokus grupe ose/dhe intervista me alumnin, me personelin ndihmësakademik si dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që kontribuojnë në realizimin e këtij</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	<i>program studim apo/dhe që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</i>			
--	---	--	--	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Rezulton që, nëpërmjet analizës SWOT të Planit Strategjik të departamentit (<i>Evidencë 4</i>), si dhe plani i vetëvlerësimit të programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” (<i>Evidencë 38</i>), institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Evidenca 12: Rregullore e zyrës, njesise se keshillimit dhe karrieres
---	--

Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rezulton se, institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave (<i>Evidencë B</i>).
--	--

Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Rezulton se, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti, siç pasqyrohet edhe në grupet e sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë si dhe në Rregulloren e Zyrës së Monitorimit. (<i>Evidencë 13</i>)
--	--

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Bazuar në Rregulloren e Mbarëvajtjes së Kurrikulave dhe Procesit Mësimor në UniBa, (<i>Evidencë 59</i>), rezulton se, institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve.
--	---

Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Rezulton se, marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me institucionet arsimore dhe jo vetem për realizimin e praktikave profesionale luajnë rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. (<i>Evidencë Dok. Shtesë 1</i>)
---	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Standardi VI.5				
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Rezulton se, institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UniBa.			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Konfirmojmë që, institucioni ka hartuar Rregulloren e UniBa (<i>Evidencë 5</i>), Rregulloren në rang njësie kryesore, si dhe Planin Strategjik të Programit të Studimit, (<i>Evidencë 4</i>) duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Evidenca 8: Rregullore e NJSBC			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Konstatojmë se, në Planin Strategjik të Programit të Studimit Master Profesional në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” është hartuar analiza SWOT e shoqëruar me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara nga ky program. (<i>Evidencë 4</i>)			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Konstatojmë se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetur në Rregulloren e NJZHKC, miratur nga Senati Akademik në vitin 2021. (<i>Evidencë 8</i>) Evidenca 52: Manuali i hartimit te programeve te studimit dhe ndryshimit te programeve ekzistuese			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimi me NJZHKC, rezultoi se , institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Barleti”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Kurrikul me fokus të përqendruar në metodologjitë e mësimdhënies dhe nxënies sportive;
2. Bashkëpunime për praktikat profesionale me një numër të konsiderueshëm institucionesh arsimore parauniversitare;
3. Nëpërmjet ndërtimit të Kampusit të ri, institucioni është angazhuar për krijimin e mjediseve të përshtashme për zhvillimin e këtij program studimi;
4. Institucioni i ka krijuar mundësi aksesimi studentëve në platformën on-line të bibliotekës, ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfrytëzimin e librave fizik dhe digjital, në bibliotekat online ndërkombëtare si: Econbiz, JSTOR, Research4life.
5. Studentët e UniBa janë të përfshirë në vendimmarrje duke u përfaqësuar në organet kolegjiale të institucionit si Senatit Akademik, Këshilli i Etikës si dhe në NjZHKC.

Pika të dobëta

1. Institucioni nuk specifikon qartë praktikën që ndjek për blerje tekstesh për shtimin e zërave të bibliotekës për propozimet që departamenti bën gjatë fillimit të vitit akademik.
2. Institucioni nuk disponon instrumente matës për numrin e studentëve të regjistruar në bibliotekën fizike dhe në bibliotekën online.
3. Plani i financimit të këtij program studimi nuk përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit.
4. Plani mësimor, i programit të studimit, nuk respekton ngarkesën në përqindje, bazuar në VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

Rekomandime

1. Rekomandohet angazhim më i madh i pedagogëve në njohjen e mësuesve të shkollave të ndryshme me vlerat e këtij programi studimi nëpërmjet trajnimeve, konferencave, etj;
2. Rekomandohet angazhim i pedagogëve në publikimin e botimeve të përbashkëta me studentët e këtij program studimi;

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al



3. Rekomandohet që institucioni të hartojë çdo vit një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit;
4. Rekomandohet hartimi i instrumenteve matës për regjistrimin e studentëve në bibliotekën fizike dhe aksesimin e tyre në bibliotekën digjitale;
5. Rekomandohet që, institucioni të rishikojë planin mësimor, të programit të studimit, në zbatim të VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

Conclusions of the study program Evaluation of the second cycle Professional Master in “Teaching in Physical Education and Sports” of Higher Education Institution "Barleti" University

Strengths and affirmations

1. Curriculum focused on teaching and learning methodologies in sports activities;
2. Collaborations for professional practices with a considerable number of pre-university educational institutions;
3. The institution is committed to creating suitable environments for the development of this study program, through the construction of the New Campus;
4. The institution has created opportunities for students to access the online platform of the library where they can submit their requests for the use of physical and digital books, in international online libraries such as: Econbiz, JSTOR, Research4life;
5. UniBa students, are involved in decision-making by being represented in the collegial bodies of the institution such as the Academic Senate, the Ethics Council and the NjZHKC.

Weaknesses

1. The institution does not clearly specify the practice it follows for purchasing textbooks to increase the library items for the proposals that the department makes during the beginning of the academic year;
2. The institution does not have measuring instruments for the number of students enrolled in the physical library and in the online library;
3. The financing plan of this study program does not contain the financing of human resources in the service of the realization of the program, the expenses for the library and the enrichment of the literature and the access to the on-line libraries, the financial obligations, the received local or foreign grants and the contracts. Related services to realize the study program.
4. The curriculum of the study program does not respect the percentage load, based on DCM No. 41 dated 21.01.2018 "On the elements of study programs offered by Higher Education Institutions", as amended.

Recommendations

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al



1. It is recommended greater involvement of lecturers in acquainting teachers at different schools with the values of this study program through trainings, conferences, etc;
2. It is recommended that lecturers be involved in common publishing, with the students of this study program;
3. It is recommended that the institution draw up a detailed plan each year to increase the number of library items and update the existing fund in support of the program;
4. It is recommended to design measuring instruments for enrolling students in the physical library and accessing them in the digital library;
5. It is recommended that the institution review the curriculum of the study program, in implementation of DCM No. 41 dated 21.01.2018 "On the elements of study programs offered by Higher Education Institutions", as amended.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al